

**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Drejtoria e Stabilitetit Financiar dhe e Politikës Makroprudenciale



***RAPORT I RREZIQEVE NË SISEMIN BANKAR TË  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR  
VITIN 2023***

Prill, 2024



## **Përmbajtja**

|             |                                                                                                        |           |
|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>I.</b>   | <b>Përmbledhje.....</b>                                                                                | <b>3</b>  |
| <b>II.</b>  | <b>Struktura e sistemit bankar .....</b>                                                               | <b>7</b>  |
| 1.          | Struktura e sistemit bankar .....                                                                      | 8         |
| 1.1.        | Karakteristikat kryesore të modelit biznesor të bankave.....                                           | 8         |
| 1.2.        | Numri i bankave dhe qasja në shërbimet bankare.....                                                    | 9         |
| 1.3.        | Punësimi në sistemin bankar .....                                                                      | 12        |
| 1.4.        | Struktura e pronësisë dhe përqendrimi i sistemit bankar .....                                          | 13        |
| <b>III.</b> | <b>Rreziqet në punën bankare .....</b>                                                                 | <b>17</b> |
|             | Harta e "nxehtësisë" për stabilitetin e sistemit bankar maqedonas.....                                 | 18        |
| 1.          | Rreziku kreditor .....                                                                                 | 21        |
| 1.1.        | Realizimi i rrezikut kreditor në bilancet e bankave .....                                              | 22        |
| 1.2.        | Testi i stresit të rezistencës së sistemit bankar ndaj rritjes së rrezikut kreditor .....              | 39        |
| 2.          | Rreziku i likuiditetit .....                                                                           | 48        |
| 2.1.        | Treguesit e likuiditetit .....                                                                         | 48        |
| 2.2.        | Dinamika e përbërjes së mjeteve likuide.....                                                           | 50        |
| 2.3.        | Struktura e maturimit të hyrjeve dhe të daljeve të dakorduara nga mjetet dhe detyrimet e bankave ..... | 51        |
| 2.4.        | Simulimet e stresit për goditjet e likuiditetit .....                                                  | 53        |
| 3.          | Rreziku valutor .....                                                                                  | 55        |
| 4.          | Rreziku i ndryshimit të normave të interesit .....                                                     | 60        |
| <b>5.</b>   | <b>Rreziku nga paaftësia e pagesës.....</b>                                                            | <b>65</b> |
| 5.1.        | Aftësia e pagesës dhe kapitalizimi i sistemit bankar .....                                             | 66        |
| 5.2.        | Cilësia e mjeteve vetanake të sistemit bankar .....                                                    | 73        |
| 5.3.        | Testi i stresit të rezistencës së sistemit bankar dhe goditjet hipotetike .....                        | 76        |
| <b>IV.</b>  | <b>Ndryshimet më të rëndësishme të bilancit dhe profitabiliteti i sistemit bankar</b>                  | <b>78</b> |
| 1.          | Aktivitetet e bankave .....                                                                            | 79        |
| 1.1.        | Kreditë e subjekteve jofinanciare .....                                                                | 81        |
| 1.2.        | Depozitat e subjekteve jofinanciare.....                                                               | 88        |
| 1.3.        | Aktivitetet e tjera.....                                                                               | 91        |
| 2.          | Profitabiliteti.....                                                                                   | 94        |
| 2.1.        | Treguesit e profitabilitetit dhe të efikasitetit të sistemit bankar .....                              | 95        |
| 2.2.        | Lëvizjet e normave të interesit dhe të dallimit të interesit.....                                      | 100       |



## I. Përmbledhje

**Në vitin 2023, mjedisi në të cilin operojnë bankat u karakterizua nga ngadalësimi gradual i inflacionit, që vazhdonte të ishte mbi mesataren historike; tregu i qëndrueshëm valutor dhe rritja e ngadalë ekonomike. Në të njëjtën kohë, rreziqet nga mjedisi dhe pasiguria rreth realizimit të tyre vazhduan të ekzistojnë dhe lidhen kryesisht me mjedisin e jashtëm. Në rrethana të tilla, rritja e aktiveve të sistemit bankar u përshpejtua, që përmirësoi treguesit e ekspozimit ndaj rreziqeve.** Në vitin 2023, ekonomia globale u përball me disa sfida, duke përfshirë pasojat e shtrëngimit të politikave monetare nga bankat qendrore të ekonomive kryesore, shqetësimet e përkohshme për stabilitetin e sistemeve bankare në SHBA dhe Europë, veprimet e mëtejshme ushtarake në Ukrainë, si dhe më vonë tendosjet në Lindjen e Mesme. Në kushtet e këtyra, BQE-ja dhe FED-i vazhduan të normalizojnë politikën monetare dhe të rrisin normat bazë të interesit në disa raste, që thuhetse përgjysmoi normat e inflacionit në Eurozonë dhe SHBA në krahasim me vitin 2022. Mjedisin ndërkombëtar kishte ndikim në ekonominë vendase dhe për rrjedhojë, reagimi i politikës monetare të Bankës Popullore nuk ndryshonte ndjeshëm nga drejtimi i politikave të bankave qendrore më me ndikim. Cikli i shtrëngimit të politikës monetare vazhdoi edhe në vitin 2023, kur norma bazë e interesit u rrit gjashtë herë në një total prej 1,55 p.p. deri në nivelin 6,30%. Pozicionin monetar e përkrahën edhe ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyrueshme për të nxitur kursimet në denarë, si dhe ndryshimet përkatëse në politikën e interesit të bankave. Në përputhje me ndryshimet monetare, u miratuan edhe masat makroprudenciale të miratuara për cilësinë e kërkesës për kredi nga personat fizikë dhe normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, që forcon më tej rezistencën e sistemit bankar. Dhe gjatë vitit 2023, treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut të sektorit bankar rezultuan të qëndrueshëm dhe të përmirësuar më tej, ndërkaj testet e stresit treguan një kapacitet të mirë të zbutjes së goditjeve të mundshme. Megjithatë, mjedisi vazhdon të jetë i pasigurt, kryesisht nën ndikimin e faktorëve negativë të jashtëm, veçanërisht të theksuar nga trazirat gjeopolitike. Prandaj, nevojitet monitorim i mëtejshëm, i kujdesshëm i rreziqeve dhe kujdes në drejtimin e politikave për të ruajtur stabilitetin e sektorit bankar edhe në periudhën e ardhshme.

**Në vitin 2023, u përshpejtua rritja e bilanceve të bankave, duke arritur në nivelin 9,1%.** Bartës të rritjes vjetore janë depozitat më të larta nga subjektet jofinanciare, kapitali dhe rezervat (për shkak të mbajtjes së fitimeve nga viti 2022 dhe emetimeve të reja të aksioneve të zbatuara) dhe fitimet e realizuara në vitin 2023. Depozitat shënuan një rritje të fortë vjetore që arritën në 9,2%, në të cilën kontribuan disi më shumë depozitat e amvisërive, ndonëse në një përshpejtim më të ndjeshëm të rritjes kontribuan edhe depozitat e ndërmarrjeve. Sa i përket strukturës valutore të depozitave, rritja vjetore e depozitave në denarë është disa herë më e lartë, krahasuar me rritjen e depozitave në valuta. Ndryshimet e favorshme strukturore të kursimeve janë të dukshme, jo vetëm në raport me valutën, por edhe në raport me maturimin e depozitave. Në kushtet e normave të kthimit gjithnjë e më të larta dhe pritshmërive të qëndrueshme, depozitat afatgjata po rriten, pas një periudhe më të gjatë reduktimi të tyre, ku shkalla vjetore e tyre arriti në 25,7%, më e larta në dhjetë vitet e fundit. Në fakt, edhe Banka Popullore mori disa masa për ndryshime të tilla strukturore, kryesisht nëpërmjet instrumentit të rezervës së detyrueshme, i cili nxit kursimin në valutën vendase.

Në aktiven e sistemit bankar, mjetet likuide shënuan rritje më të ndjeshme, si dhe rritje më të madhe shënuan edhe kreditë (4,3%), por dukshëm më ngadalë në krahasim me vitin e mëparshëm.



Ngadalësimi i aktivitetit kreditor ishte më pak i theksuar te kreditë e amvisërive, e cila kontribuoi më së shumti në rritjen vjetore të totalit të kredive të personave jofinanciarë.

**Aftësia e pagesës e sistemit bankar shënon përmirësime.** Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë vitit 2023 arriti në nivelet që janë më të lartat e analizuara që nga viti 2007 dhe në fund të vitit është 18,1%, që është për 0,4 p.p. më shumë krahasuar me 31.12.2022. Analizuar sipas përdorimit, rreth 35% e mjeteve të veta të sistemit bankar u përkasin shtresave mbrojtëse të kapitalit ose janë "të lira" mbi nivelin minimal të kërkuar dhe mund të përdoren nga bankat për të përballuar sfida të ndryshme gjatë lëvizjeve në rënie gjatë cikleve ekonomike dhe në kushte krize. Testimi i stresit i kryer tregon qëndrueshmërinë e sistemit bankar ndaj goditjeve të simuluar.

**Për të forcuar më tej rezistencën e sistemit bankar, gjatë mosrealizimit të rreziqeve në bilancet e bankave dhe të përfitimit të qëndrueshëm, Banka Popullore rriti për disa herë gjatë vitit 2023 nivelin e shtresës kundërciklike të mbrojtjes së kapitalit që bankat duhet të ruajnë.** Duke filluar nga 1 gushti 2023, shtresa e mbrojtjes kundërciklike për bankat është 0,5%. Duke filluar nga janari 2024, kjo shkallë është 0,75%, 1% nga korriku i vitit 2024, 1,25% nga nëntori i vitit 2024 dhe 1,5% nga janari i vitit 2025. Me rritjen e kërkesave kapitale, bankat pritet të ruajnë prirjen e përmirësimit të aftësisë së pagesës të sistemit bankar në periudhën e ardhshme.

**Treguesit e likuiditetit janë përmirësuar në vitin 2023 dhe janë në nivele të kënaqshme.** Mjetet likuide të sistemit bankar shënuan një rritje solide dyshifrore, prej 15,3%, në vitin 2023, që mundësoi përmirësimin e treguesve nëpërmjet të cilëve monitorohet dhe vlerësohet likuiditeti. Kështu, mjetet likuide zënë 31,8% të totalit të aktives së bankave (30% më 31.12.2022), ndërsa mbulimi i detyrimeve afatshkurtra dhe depozitave të amvisërive me mjete likuide është 52,3%, përkatësisht 65,3% (më 31.12.2022). Në vitin 2022, këta tregues ishin 47,7%, përkatësisht 61,1%. Shkalla e mbulimit të likuiditetit të sistemit bankar është 263,5%, që është dukshëm më shumë se minimumi rregullator (100%) dhe konfirmon sasinë e kënaqshme të likuiditetit në dispozicion të sistemit bankar maqedonas. Rezultatet e testeve të stresit tregojnë një rezistencë të kënaqshme të sistemit bankar ndaj daljeve të supozuara ekstreme, individuale dhe të kombinuara të likuiditetit.

**Portofoli kreditor i bankave është i një cilësie solide. Në vitin 2023, kreditë me probleme të subjekteve jofinanciare u rritën minimalisht (0,2%), kurse pjesëmarrja e tyre në totalin e kredive vazhdoi të ulet dhe në fund të vitit u ul në minimumin historik prej 2,8% (për herë të parë në mars të vitit 2023).** Sipas sektorëve të veçantë, kreditë me probleme të ndërmarrjeve shënuan rënie (për -2,8%), pra pjesëmarrja e tyre në totalin e kredive arriti në një minimum historik prej 3,7% në fund të vitit. Rënia vjetore e kredive me probleme të ndërmarrjeve vjen më së shumti nga fshirjet e detyrueshme të këtyre kredive të kryera gjatë vitit, si dhe u mor përsipër një sasi solide e pasurisë së vendosur si kolateral për kërkesat e pashlyeshme, duke penguar kështu një rritje më të ndjeshme të totalit të kredive me probleme të ndërmarrjeve në vitin 2023. Në portofolin kreditor të përbërë nga amvisëritë, kreditë me probleme shënuan rritje mesatare (3,4%), për të tretin vit radhazi, por në kushtet e rritjes së mëtejshme solide të kredive të këtij sektori, pjesëmarrja e kredive me probleme në kreditë totale mbeti në të njëjtin nivel me një vit më parë (1,9%). Rritja e kredive me probleme të amvisërive rezulton kryesisht nga kreditë e paracaktuara për financimin e konsumit të personave fizikë, ndërsa në një masë më të vogël nga rritja e kredive me probleme të paracaktuara për blerjen e pasurive të paluajtshme dhe për tregtarët me pakicë.



**Nga 1.7.2023 filloi zbatimi i masave makroprudenciale që kufizojnë sasinë e treguesve DSTI<sup>1</sup> (në 55% dhe 50%, varësisht nga aprovimi i kredive në denarë ose me komponent valutë) dhe LTV<sup>2</sup> (85% gjatë miratimit të ekspozimit të ri ose rritjes së atij ekzistues të siguruar me pasuri të paluajtshme). Masat e ndërmarra ndikojnë në cilësinë e kërkesës së kreditimit nga personat fizikë, për të parandaluar huazimit e tepruar të personave fizikë individualë. Në këtë mënyrë parandalohet akumulimi i rreziqeve sistemore në segmentin e amvisërive dhe në tregun e pasurive të paluajtshme, të cilat mund të realizoheshin në formën e humbjeve nga kreditë pranë bankave. Bankat janë të kujdesshme dhe zbatojnë tregues më të ulët nga ato të përcaktuara.**

**Nga fillimi i vitit 2024 është zbatuar Vendimi i ri për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut kreditor, i cili përafrohet më tej me kërkesat rregullatore të zbatuara në Bashkimin Europian dhe kontribuon në forcimin e mëtejshëm të stabilitetit të sistemit bankar.** Vendimi përcaktoi një mënyrë të re të vërtetimit të ekspozimeve kreditore me probleme, forcoi kriteret e monitorimit dhe të kontrollit të cilësisë së portofolit kreditor të bankave dhe avancoi rregullat e rishtrukturimit të ekspozimeve kreditore të bankave. Ndryshimet metodologjike në vërtetimin e kredive me probleme mund të çojnë në rritjen e tyre, të paktën në periudhën fillestare pas zbatimit të Vendimit, që është më shumë efekt i qasjes së ndryshme në përcaktimin e statusit me probleme (duke numëruar ditët e vonësës), sesa të aftësisë kreditore të ndryshuar të klientëve. Prandaj është e rëndësishme që huamarrësit të jenë të vetëdijshëm për këto ndryshime rregullatore, në mënyrë që të jenë të rregullt në shlyerjen e detyrimeve dhe të mos e vështirësojnë qasjen e tyre në kredit e bankave në të ardhmen.

**Në vitin 2023, prania e komponentit valutë (valuta e jashtme dhe klauzola valutë) në bilancet e bankave pësoi rënie dhe në fund të vitit ishte 42,4% në aktiven dhe 41,2% në pasiven. Këto ndryshime janë mbështetur edhe nga ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyrueshme, të cilat kishin për qëllim rritjen e denarizimit, ku vërehen prirje pozitive<sup>3</sup>. Ekspozimi i sistemit bankar ndaj rrezikut valutë është në një nivel dukshëm më të ulët se kufiri rregullator prej 30% të mjeteve të veta dhe më 31.12.2023 është 10,7%.**

**Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të ndryshimeve të normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare** është brenda kornizës së përcaktuar (20%) dhe më 31.12.2023 është 9% të mjeteve të veta, që paraqet një rënie vjetore prej 1,1 p.p. Në kushtet e rritjes së normave të interesit, rritet rëndësia e ekspozimit të bankave ndaj rrezikut të tërthortë kreditor, që rezultojnë nga pjesëmarrja e lartë e kredive me normë interesi të ndryshueshme dhe të rregullueshme në portofolin kreditor. Megjithatë, bankat u treguan relativisht të kujdesshme dhe rritën gradualisht normat e interesit të kredive, që pengoi një realizim më domethënës të rrezikut kreditor në vitin 2023, si rezultat i borxhit më të lartë me interes të klientëve.

**Në vitin 2023, profitabiliteti e sistemit bankar vendas u përmirësua.** Në kushtet e rritjes së normave të interesit dhe të aktiveve me interes, fitimi më i lartë (për 47,8% krahasuar me vitin

<sup>1</sup> DSTI është një tregues i raportit ndërmjet detyrimeve të shlyerjes në bazë të kredive dhe të të hyrave të personave fizikë në baza mujore.

<sup>2</sup> LTV është një tregues i raportit ndërmjet masës së ekspozimit kreditor të personave fizikë dhe vlerës së pasurisë së paluajtshme të lënë peng.

<sup>3</sup> Në vitin 2023, shkalla e rezervës së detyruar të detyrimeve në valuta u rrit nga 19% në 21%, kurse pjesëmarrja e rezervës së detyrueshme në euro, që plotësohet në euro, u rrit nga 75% në 81%. Po ashtu, u rrit edhe shkalla e rezervës së detyrueshme, e cila zbatohet për detyrimet në denarë me klauzolë devizore, nga 50% në 100%, me ç'rast, në përputhje me ndryshimin, bankat do ta përmbushin detyrimin e rezervës së detyrueshme, të llogaritur nga këto detyrime, në valuta. Këto ndryshime në instrumentin e rezervës së detyrueshme janë të menduara për nxitjen e kursimeve në denarë dhe për të bërë ndryshimet e duhura në politikën e interesit të bankave.



e kaluar) u kushtëzua nga rritja e të hyrave neto nga interesi, për të cilin kontribuan të hyrat nga interesi nga thuajse të gjithë sektorët. Një kontribut të vogël në rritjen e fitimit kishin të hyrat neto më të larta nga provizionet. Normat e kthimit të aktives mesatare, kapitalit dhe rezervës mesatare janë 2,0%, përkatësisht 16,1%, që është një performancë më e mirë krahasuar me vitin e kaluar (1,5%, përkatësisht 12,2%). Zërat kryesorë të shpenzimeve të bankave shënuan rritje në vitin 2023, veçanërisht në ato operative (rritje prej 14,6%), si dhe rritje mesatare prej 3,2% u shënuan edhe në shpenzimet e zhvlerësimit.

**Në përgjithësi, në vitin 2023 sektori bankar ruajti stabilitetin dhe besueshmërinë e tij në operacione, me përmirësimin e aftësisë së pagesës dhe likuiditetit dhe të cilësisë së mirë të portofolit kreditor.** Testet e stresit konfirmojnë rezistencën e sistemit ndaj goditjeve, e cila forcohet më tej nga masat makroprudenciale të miratuara. Megjithatë, kushtet vazhdojnë të jenë të pasigurta dhe vazhdon të ketë rreziqe për ekonominë globale dhe vendase në afat të shkurtër dhe të mesëm. Prandaj, nevojitet një kujdes i mëtejshëm, veçanërisht në monitorimin dhe menaxhimin e rrezikut kreditor, rëndësia e të cilit rritet në kushtet e një mjedisi të pasigurt dhe të kushteve të shtrënguara financiare. Banka Popullore po monitoron me vigjilencë të gjitha ngjarjet dhe është e gatshme të marrë të gjitha masat e nevojshme në kompetencën e saj, sa herë që është e nevojshme.



## **II. Struktura e sistemit bankar**



## 1. Struktura e sistemit bankar


### 1.1. Karakteristikat kryesore të modelit biznesor të bankave

**Mbledhja e depozitave dhe dhënia e kredive janë aktivitetet themelore të sistemit bankar maqedonas. Kështu, në vitin 2023, gjithsej depozitat marrin pjesë me 77,4% të totalit të detyrimeve dhe gjithsej kreditë marrin pjesë me 59,1% të totalit të aktives.** Burimi më i rëndësishëm i financimit të bankave janë depozitat e amvisërive, pjesëmarrja e të cilave në totalin e detyrimeve të sistemit bankar është 47,4%, që është 0,6 pikë përqindjeje më pak krahasuar me 31.12.2022. Analiza sipas bankave të veçanta tregon se depozitat e amvisërive janë burimi më i rëndësishëm i financimit në dhjetë banka; në një bankë, depozitat e amvisërive dhe ndërmarrjet kanë pothuajse të njëjtën pjesëmarrje; në një bankë mbizotërojnë depozitat e ndërmarrjeve, ndërsa një bankë nuk mbledh depozita fare dhe si burim financimi përdor linjat e kreditimit të institucioneve financiare ndërkombëtare.

Nga ana e aktives, kreditë e sektorit jofinanciar kanë pjesëmarrje më të madhe prej 56,6%, e cila shënon një rënie prej 2,5 pikë përqindjeje, krahasuar me 31.12.2022. Në të njëjtën kohë, kreditë e amvisërive kanë një pjesëmarrje pak më të lartë (29,6%), krahasuar me kreditë e shoqërive jofinanciare (26,6%)<sup>4</sup>. Analizuar sipas bankave individuale, kreditë e amvisërive janë dukshëm më të larta në gjashtë banka, ndërsa kreditë e ndërmarrjeve janë dukshëm më të larta në dy banka; katër banka kanë përqindje të ngjashme të kredive për të dy sektorët, kurse në një bankë mbizotërojnë kreditë e dhëna për bankat vendase. Segmenti tjetër më i rëndësishëm i aktiveve janë mjetet likuide.

Grafiku nr. 1

Struktura e aktives (majtas) dhe e pasives (djathtas) e bankave dhe e sistemit bankar më 31.12.2023 \* në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* Renditja e bankave është e rastësishme.

<sup>4</sup> Për qëllime të kësaj analize, kreditë llogariten mbi bazën kontabël neto (pas zhvlerësimit dhe amortizimit të akumuluar).




**Në strukturën e të hyrave totale të bankave, mbizotërojnë të hyrat neto nga interesi, që korrespondojnë me modelin tradicional të biznesit të bankave.** Pjesëmarrja e tyre është 70,7%, që është për 8,1 pikë përqindje më shumë se në vitin 2022. Nga ana tjetër, për shkak të rritjes së pjesëmarrjes së këtij zëri, pjesëmarrja e të hyrave neto nga provizionet, e cila është 18,4%, shënoi një rënie prej 3,7 pikë përqindjeje, ndërsa të hyrat e tjera shënojnë rënie për 4,4 pikë përqindjeje dhe bëjnë 10,9% të të hyrave totale. Në kuadër të të hyrave neto nga interesi, pjesën më të madhe (31,4%) e zënë të hyrat neto nga interesi nga puna me amvisëritë, kurse të hyrat neto nga interesat nga puna me ndërmarrjet zënë 26,7%. Raporti i këtyre dy kategorive të të hyrave neto nga interesi në banka korrespondon në një masë të caktuar me raportin e pjesëmarrjes së kredive të miratuara për këto dy grupe kërkuesish të kredive. Rrjedhimisht, të hyrat neto nga interesi nga puna me amvisëritë janë dukshëm më të larta në gjashtë banka; të hyrat neto nga interesi nga puna me ndërmarrjet mbizotërojnë në katër banka; dy banka kanë një raport të ngjashëm të të hyrave neto nga interesi në të dyja bazat, ndërsa në një bankë mbizotërojnë të hyrat totale neto nga interesi nga puna me institucionet financiare.

**Tri zëra mbizotërojnë në shpenzimet në nivel të sistemit bankar.** Pjesëmarrjen më të lartë e zënë shpenzimet për punonjës (31,6%), të ndjekura nga shpenzimet e përgjithshme e administrative (27,5%), si dhe zhvlerësimi i mjeteve financiare dhe jofinanciare (20,5%)

Grafiku nr. 2

Struktura e të hyrave totale (majtas) dhe e shpenzimeve totale (djathtas) e bankave dhe sistemit bankar më 31.12.2023 \* në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* Renditja e bankave është e rastësishme.

## 1.2. Numri i bankave dhe qasja në shërbimet bankare


**Më 31.12.2023, sistemi bankar maqedonas përbëhet nga pesëmbëdhjetë institucione depozituese, përkatësisht trembëdhjetë banka dhe dy kursimore<sup>5</sup> dhe nuk janë vërejtur ndryshime, krahasuar me një vit më parë.**

<sup>5</sup> Pjesëmarrja e kursimoreve në totalin e mjeteve të institucioneve financiare depozituese (bankat dhe kursimoret) është 0,3%; në totalin e kredive të subjekteve jofinanciare, 0,4%; në totalin e depozitave të amvisërive, 0,2%. Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e

**Rrjeti bankar është i shtrirë thuajse në të gjitha qytetet e vendit dhe përbëhet nga 376 njësi biznesi<sup>6</sup>.** Numri total i njësive të biznesit vijon të ulet dhe krahasuar me një vit më parë, është ulur me 6 njësi dhe ky ndryshim është i njëtrajtshëm në të gjitha qarqet planifikuese të vendit. Pjesa më e madhe e numrit të përgjithshëm të njësive të biznesit (43,9%) janë të vendosura në rajonin e Shkupit, ku qasja fizike në shërbimet bankare<sup>7</sup> është më e lehtë, kurse qasja më e vështirë në shërbimet bankare vërehet në rajonet verilindore dhe të Pollogut. Për më tepër, një përkeqësim më i theksuar i qasjes në shërbimet bankare vërehet në rajonet verilindore dhe juglindore, ndërsa qasja në rajonin e Pollogut është duke u përmirësuar në krahasim me vitin e mëparshëm. Mirëpo, duhet pasur parasysh se qasja fizike është vetëm një masë e qasjes total në shërbimet bankare sepse disa nga shërbimet e tyre bankat i ofrojnë edhe në mënyrë elektronike. Nga teksti në kornizë mund të vërehet se pjesa e llogarive të pagesave që kanë mundësinë e përdorimit të shërbimeve bankare online (shikimi i raporteve dhe/ose pagesat) po rritet, megjithëse pjesa e llogarive që përdoren në mënyrë aktive për këto qëllime ka ulur.

Grafiku nr. 3

Rrjeti bankar (majtas) dhe numri i banorëve për njësi biznesi (djathtas) sipas rajoneve të veçanta të planifikimit



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat dhe Enti Shtetëror i Statistikës sipas të dhënave zyrtare nga Regjistrimi i vitit 2021.

### Analiza e përhapjes së bankingut elektronik

**Zbatimi i teknologjive digjitale në funksionimin e bankave kontribuon në zgjerimin e gamës së produkteve dhe të shërbimeve dhe disponueshmërinë më të madhe të tyre për klientët e bankave. Ndryshime të tilla ndoshta mund të lidhen me dinamikën e reduktimit**

parëndësishme të kursimoreve në sistemin e përgjithshëm bankar, ato janë objekt i analizës vetëm në raportet e stabilitetit financiar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa analizat në këtë raport përfshijnë vetëm bankat.

<sup>6</sup> Numri i njësive të biznesit përfshin degët, duke përfshirë edhe selitë e bankave.

<sup>7</sup> Qasja fizike në shërbimet bankare matet me numrin e personave për njësi biznesi, kështu që vlera më e lartë tregon qasjen më të vështirë dhe vlera më e ulët tregon qasjen më të lehtë.




të numrit të njësive të biznesit të bankave. Qëllimi i kësaj analize është të tregojë përhapjen e bankingut elektronik dhe shpërndarjen e tij sipas rajoneve. Njëkohësisht, si masë për banking elektronik, janë marrë edhe llogaritë aktive të pagesave, të cilat u mundësojnë personave fizikë dhe juridikë të shqyrtojnë raportet dhe të kryejnë pagesa.

**Numri i llogarive aktive të pagesave përmes kompjuterit personal (PC) ose pajisjes tjetër të pagesave dhe të raporteve të personave fizikë në fund të vitit 2023 shënuan rritje prej 12,6% me bazë vjetore, që është rezultat i rritjes së numrit të llogarive nga të cilat kryhen pagesat, të cilat më parë përdorehin vetëm për kontrollimin e raporteve. Të analizuar sipas rajoneve, shkallët vjetore të rritjes së numrit të llogarive aktive të personave fizikë përmes PC-së ose mjeteve të tjera të pagesës dhe raportimit janë të ngjashme kudo dhe ndryshojnë nga 11,1% në rajonin jugperëndim, deri në 14,8% në atë juglindor. Në strukturën e totalit të llogarive të pagesave të personave fizikë, pjesëmarrja e llogarive ku nuk ka qasje nëpërmjet PC-së apo ndonjë pajisjeje tjetër për pagesa dhe raporte ulet për 3,5 pikë përqindje, por niveli prej 54,7% vazhdon të jetë i lartë.**

Grafiku nr. 4

Struktura e llogarive të pagesave të personave fizikë (majtas) dhe personave juridikë (djathtas)

në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat e biznesit.

**Rritje vërehet edhe në numrin e llogarive aktive të pagesave nëpërmjet PC-së ose një pajisjeje tjetër për pagesat dhe raportimet e personave juridikë, por me një rritje vjetore më të ulët prej 6,3% në fund të vitit 2023.** Analiza e ndryshimit vjetor të numrit të llogarive aktive të personave juridikë përmes PC-së ose një pajisjeje tjetër për pagesa dhe raporte tregon rritjen më të lartë në rajonin e Pollogut dhe të Pellagonisë (për 13,3%, përkatësisht 10,9%), ndërsa u vërejt një rënie në rajonet verilindore dhe jugperëndimore (për 9,2%, përkatësisht 2,0%). Krahasuar me personat fizikë, përqindja e llogarive të pagesave të cilat nuk ka qasje nëpërmjet PC-së apo ndonjë pajisjeje tjetër pagese dhe kontrollimi i raporteve është thajse dyfish më i ulët te personat juridikë, që gjatë vitit 2023 është ulur më tej për 3,7 pikë përqindjeje, deri në nivelin prej 24,8%.



Grafiku nr. 5

Pjesëmarrja e numrit të llogarive aktive të pagesave përmes PC-së ose pajisjes tjetër të personave fizikë (majtas) dhe personave juridikë (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat e biznesit.

**Një rënie e pjesëmarrjes së numrit të llogarive aktive të pagesave përmes PC-së ose një pajisje tjetër të personave fizikë në numrin total të llogarive të pagesave në fund të vitit 2023 vihet re në të gjitha rajonet.** Rënia më e theksuar e pjesëmarrjes ndodh në rajonin e Pollogut (21,0% më 31.12.2023, kundrejt 26,2% më 31.12.2022). Pjesëmarrjen më të madhe e ka rajoni i Shkupit prej 26,8 për qind, ndërsa me më të ulët prej 18,5 për qind është rajoni i Pellagonisë. Sa u përket llogarive të përdorura për pagesa krahas raporteve të kontrollimit, dallimet janë më të dukshme dhe rajoni i Shkupit dallohet me pjesëmarrje prej 12,0%, pasuar nga rajoni jugperëndimor dhe ai lindor me nga 6,9% secili, si dhe përqindja është më e ulët në rajonin e Pollogut me 4,3%.

**Një rënie e përqindjes së numrit të llogarive aktive të pagesave përmes PC-së ose një pajisje tjetër në fund të vitit 2023 ndodh në të gjitha rajonet dhe midis personave juridikë.** Në të njëjtën kohë, rënie më të ndjeshme prej 5.4 pikë përqindje ka në rajonin verilindor, pjesëmarrja e të cilit prej 42,1% është më e ulët sipas rajoneve. Nga ana tjetër, përqindjen më të lartë e ka rajoni i Shkupit me 66,4%. Te llogaritë aktive të pagesave për pagesat, përveç raporteve të kontrollimit, përqindja sipas rajoneve ndryshon nga 29,3% në jugperëndim, deri në 42,8% në rajonin e Shkupit.

### 1.3. Punësimi në sistemin bankar


**Numri i personave të punësuar në sistemin bankar më 31.12.2023 është 5,907 dhe ka një rritje prej 77, krahasuar me një vit më parë.** Sipas shkallës së arsimit të përfunduar, struktura e kualifikimit të punonjësve është përmirësuar, kështu që pjesëmarrja e punonjësve me të paktën arsim të lartë është 86,6%, që është më shumë për 0,6 pikë përqindje në bazë vjetore.



**Produktiviteti i sistemit bankar<sup>8</sup> shënon rritje, që vjen si pasojë e rritjes më të madhe të aktives nga numri i të punësuarve** Të gjitha bankat e analizuara shënuan rritje të produktivitetit dhe gjysma e tyre shënuan shkallë rritjeje dyshifrore. Ndryshimet në produktivitet ndërmjet bankave vazhdojnë të konsiderueshme dhe ndryshojnë nga 29,4 milionë denarë në bankën me produktivitet më të ulët, deri në 211,6 milionë denarë për punonjës në bankën me produktivitet më të lartë.

Grafiku nr. 6


Numri i punonjësve në sistemin bankar



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 7

Aktivja sipas të punësuarve \* në milionë denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* "BZHRMV" ShA Shkup nuk është përfshirë në analizë për shkak të aktivitetit që kryen.

#### 1.4. Struktura e pronësisë dhe përqendrimi i sistemit bankar

**Bankat me pronësi kryesisht të huaj mbizotërojnë në strukturën e pozicioneve më të rëndësishme nga bilancet e sistemit bankar në vitin 2023. Nëntë nga trembëdhjetë banka janë kryesisht me pronësi të huaj, pesë prej të cilave janë filiale të bankave të huaja.** Pjesëmarrjen më të theksuar në kreditë e subjektet jofinanciare kanë bankat me kapital të huaj (83,1%), që paraqet një rritje prej 1,1 pikë përqindjeje, krahasuar me një vit më parë. Për pjesën tjetër të pozicioneve nga bilancet e sistemit bankar, një rritje më e ndjeshme prej 1,1 pikë përqindjeje është shënuar në kapital dhe rezerva, ndërsa një rënie prej 1,5 pikë përqindjeje është shënuar në pjesëmarrjen e bankave të huaja në rezultat financiar.

<sup>8</sup> Produktiviteti në sistemin bankar matet me totalin e aktives për punonjës, kështu që një shumë më e lartë tregon produktivitet më të lartë, kurse një shumë më e ulët tregon produktivitet më të ulët.



Tabela nr. 1

Struktura e numrit të bankave dhe pozicioneve më të rëndësishme nga bilancet sipas pronësisë mbizotëruese të bankave më 31.12.2023

në milionë denarë dhe në përqindje

| Lloji i pronësisë                                           | Numri i bankave | Kapitali dhe rezervat |               | Aktiva         |               | Kredi të sektorit jofinanciar |               | Depozita nga sektori jofinanciar |               | Të hyra totale* |               | Rez. finan.   |
|-------------------------------------------------------------|-----------------|-----------------------|---------------|----------------|---------------|-------------------------------|---------------|----------------------------------|---------------|-----------------|---------------|---------------|
|                                                             |                 | Shuma                 | Në %          | Shuma          | Në %          | Shuma                         | Në %          | Shuma                            | Në %          | Shuma           | Në %          |               |
| <b>Banka me shumicë të pronësisë së aksionerëve të huaj</b> | <b>9</b>        | <b>72.137</b>         | <b>77,6%</b>  | <b>543.286</b> | <b>72,8%</b>  | <b>366.043</b>                | <b>83,1%</b>  | <b>381.981</b>                   | <b>70,8%</b>  | <b>27.115</b>   | <b>76,2%</b>  | <b>10.707</b> |
| - filialet e bankave të huaja                               | 5               | 63.305                | 68,1%         | 453.717        | 60,8%         | 310.604                       | 70,5%         | 320.851                          | 59,5%         | 23.000          | 64,6%         | 9.453         |
| - Austria                                                   | 1               | 10.808                | 11,6%         | 94.848         | 12,7%         | 67.398                        | 15,3%         | 58.600                           | 10,9%         | 3.692           | 10,4%         | 1.462         |
| - Bullgaria                                                 | 1               | 1.307                 | 1,4%          | 12.377         | 1,7%          | 7.511                         | 1,7%          | 9.174                            | 1,7%          | 455             | 1,3%          | 54            |
| - Greqia                                                    | 1               | 22.258                | 24,0%         | 131.762        | 17,6%         | 94.229                        | 21,4%         | 99.235                           | 18,4%         | 7.920           | 22,3%         | 3.470         |
| - Sllovenia                                                 | 1               | 13.546                | 14,6%         | 116.581        | 15,6%         | 77.824                        | 17,7%         | 91.365                           | 16,9%         | 6.067           | 17,0%         | 3.217         |
| - Turqia                                                    | 1               | 15.386                | 16,6%         | 98.149         | 13,1%         | 63.643                        | 14,4%         | 62.477                           | 11,6%         | 4.866           | 13,7%         | 1.250         |
| - banka tjera me shumicë pronësie të huaj                   | 4               | 8.832                 | 9,5%          | 89.569         | 12,0%         | 55.439                        | 12,6%         | 61.131                           | 11,3%         | 4.115           | 11,6%         | 1.254         |
| - Bullgaria                                                 | 2               | 3.987                 | 4,3%          | 31.075         | 4,2%          | 18.972                        | 4,3%          | 21.412                           | 4,0%          | 1.792           | 5,0%          | 482           |
| - Gjermania                                                 | 1               | 4.019                 | 4,3%          | 49.526         | 6,6%          | 31.103                        | 7,1%          | 33.061                           | 6,1%          | 1.858           | 5,2%          | 616           |
| - Zvicra                                                    | 1               | 827                   | 0,9%          | 8.968          | 1,2%          | 5.364                         | 1,2%          | 6.658                            | 1,2%          | 465             | 1,3%          | 156           |
| <b>Bankat me shumicë pronësie të aksionerëve vendas</b>     | <b>4</b>        | <b>20.773</b>         | <b>22,4%</b>  | <b>203.454</b> | <b>27,2%</b>  | <b>74.517</b>                 | <b>16,9%</b>  | <b>157.621</b>                   | <b>29,2%</b>  | <b>8.476</b>    | <b>23,8%</b>  | <b>3.588</b>  |
| - pronë private                                             | 3               | 17.233                | 18,5%         | 184.980        | 24,8%         | 74.288                        | 16,9%         | 157.621                          | 29,2%         | 8.241           | 23,2%         | 3.497         |
| - pronë shtetërore                                          | 1               | 3.540                 | 3,8%          | 18.473         | 2,5%          | 229                           | 0,1%          | 0                                | 0,0%          | 235             | 0,7%          | 92            |
| <b>Gjithsej:</b>                                            | <b>13</b>       | <b>92.910</b>         | <b>100,0%</b> | <b>746.739</b> | <b>100,0%</b> | <b>440.560</b>                | <b>100,0%</b> | <b>539.602</b>                   | <b>100,0%</b> | <b>35.590</b>   | <b>100,0%</b> | <b>14.296</b> |

Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.


**Institucionet financiare mbizotërojnë strukturën e pronësisë së bankave me afro dy të tretat (65,7%).** Pjesëmarrja e tyre në kapitalin dhe rezervat e sistemit bankar më 31.12.2023 është rritur për 1,3 pikë përqindje. Kjo rritje vjen si pasojë e uljes së pjesëmarrjes së personave juridikë jofinanciarë për 0,5, të personave fizikë për 0,4 dhe të sektorit shtetëror për 0,3 pikë përqindje.

Në fund të vitit 2023, aksionarët e huaj kanë një pjesëmarrje totale në kapitalin dhe rezervat e sistemit bankar prej 73,5%, e cila është më e lartë për 1,1 pikë përqindje, krahasuar me fundin e vitit 2022. Shumica e aksionarëve janë nga Bashkimi European (55,5%). Sipas vendeve individuale, pjesëmarrjen më të lartë në totalin e kapitalit dhe rezervave e mbajnë aksionarët nga Greqia (22,1%), Turqia (16,5%), Sllovenia (12,8%) dhe Austria (11,3%).




Grafiku nr. 8

Struktura e pronësisë së kapitalit dhe e rezervave të sistemit bankar në përqindje



Grafiku nr. 9

Indeksi i Herfindalit në pikë indeksi



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Përqendrimi i aktiviteteve bankare në vitin 2023** shënon rritje të kreditimit dhe rënie të përqendrimit në depozita dhe në totalin e aktives. Sa u përket depozitave të amvisërive, vlera e këtij indeksi shënon rënie **në kornizat e vlerave të pranueshme<sup>9</sup> dhe të indeksit të Herfindalit<sup>10</sup>**, ku përfshihen të gjitha kategoritë e tjera të aktiviteteve.

**Treguesit e përqendrimit në sistemin bankar midis tre dhe pesë bankave më të mëdha tregojnë ndryshime të vogla në baza vjetore.** Më e dukshme është rënia e pjesëmarrjes së tri bankave më të mëdha në totalin e aktives dhe të aktiviteteve bankare me amvisëritë, por edhe në rezultatin financiar dhe të të hyrave totale, ndërkaj rritje e pjesëmarrjes së pesë bankave më të mëdha në aktivitetin kreditor.

Tabela nr. 2

Treguesit e përqendrimit të pozicioneve më të rëndësishme nga bilancet e tri dhe pesë bankave më të mëdha në përqindje

| Pozita                             | 31.12.2023 |      | 31.12.2022 |      |
|------------------------------------|------------|------|------------|------|
|                                    | CR3        | CR5  | CR3        | CR5  |
| Total aktivi                       | 55,2       | 81,0 | 56,5       | 81,5 |
| Kredite të amvisërive              | 62,0       | 84,1 | 61,3       | 83,6 |
| Kredite të shoqërive jofinanciare  | 52,8       | 82,3 | 51,7       | 81,0 |
| Depozita të amvisërive             | 68,0       | 85,5 | 70,1       | 86,1 |
| Depozita të shoqërive jofinanciare | 54,6       | 81,5 | 54,4       | 83,2 |
| Rezultat financiar                 | 71,8       | 90,8 | 72,6       | 91,0 |
| Të hyra totale                     | 59,2       | 83,2 | 60,4       | 82,6 |

<sup>9</sup> Niveli i përqendrimit konsiderohet i pranueshëm kur indeksi lëviz nga 1.000 deri në 1.800 pikë.

<sup>10</sup> Indeksi i Herfindalit llogaritet sipas formulës  $HI = \sum_{j=1}^n (S_j)^2$ , me ç'rast  $S$  është pjesëmarrja e çdo banke në vlerën e përgjithshme të kategorisë që analizohet (për shembull: aktivja totale, depozitat totale etj.), ndërkaj  $n$  është numri i përgjithshëm i bankave në sistem.




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Dallimet midis bankave individuale sipas madhësisë së aktives vazhdojnë të konsiderueshme.** Dallimi ndërmjet bankës me pjesëmarrjen më të lartë (21,9%) dhe bankës me pjesëmarrjen më të ulët (0,4%) në totalin e aktives së sistemit bankar është thujtë i pandryshuar, krahasuar me vitin 2022. Pesë bankat më të mëdha me një pjesëmarrje totale prej 81% janë të vetmet me një pjesëmarrje dyshifrore në totalin e aktives, ndërsa pesë bankat më të vogla kanë një pjesëmarrje individuale të tregut prej më pak se 2%, ndërsa pjesëmarrja e tyre totale është 6,1%.

Grafiku nr. 10

Pjesëmarrja e bankave individuale në totalin e aktives së sistemit bankar në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.



### **III. Rreziqet në punën bankare**



## Raport i rreziqeve në sistemin bankar për vitin 2023

### Harta e "nxehtësisë" për stabilitetin e sistemit bankar maqedonas

| Tregues për ekspozimin e rreziqeve                                                                          | 10 vitet e fundit (1.1.2014 - 31.12.2023)* |           |           |           |            | 5 vitet e fundit (1.1.2019 - 31.12.2023)** |           |           |           |            |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|-----------|-----------|-----------|------------|--------------------------------------------|-----------|-----------|-----------|------------|
|                                                                                                             | 31.12.2022                                 | 31.3.2023 | 30.6.2023 | 30.9.2023 | 31.12.2023 | 31.12.2022                                 | 31.3.2023 | 30.6.2023 | 30.9.2023 | 31.12.2023 |
| <b>Rreziku i mosfatisëse paguese</b>                                                                        |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kapitali dhe rezerva/aktiva                                                                                 |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Norma e përshtatshmërisë së kapitalit                                                                       |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Norma e kapitalit bazë                                                                                      |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kreditë me probleme neto nga rezervimet (sektori jofinanciar)/mjete vetanake                                |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| <b>Rrezik kreditor</b>                                                                                      |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Normat e mospagimit të ekspozimit të kredisë ndaj sektorit jofinanciar                                      |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kredi të ristrukturuara dhe të dhëna për individë dhe ndërmarrje / kredi për individë dhe ndërmarrje        |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kreditë me probleme / totali (sektori jofinanciar)                                                          |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Mbulimi i kredive me probleme me zhvlerësimi total dhe rezerva speciale                                     |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Niveli mesatar i rrezikshmërisë së ekspozimit të kredisë                                                    |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kostoja e korrigjimit të vlerës dhe rezerva speciale/kredi për sektorin jofinanciar                         |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| <b>Rreziku i likuiditetit</b>                                                                               |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Aktiva likuide / aktiva totale                                                                              |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Aktiva likuide / detyrime afatshkurtëra                                                                     |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kredi/depozita                                                                                              |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Aktiva likuide/depozita të amvisërive                                                                       |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| <b>Rreziqet e tregut dhe rreziku indirekt i kredisë</b>                                                     |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Pozicioni i hapur valutë / mjete vetanake                                                                   |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Pozicioni i ponderuar neto (ekspozimi ndaj rrezikut të ndryshimeve të normave të interesit)/ mjete vetanake |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kredi me komponentë valutore / kredi totale                                                                 |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kredi me normë interesi të rregullueshme dhe të ndryshueshme / kredi totale                                 |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| <b>Profitabiliteti</b>                                                                                      |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Kthimi i aktiveve mesatare                                                                                  |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Të hyrat neto të interesit/ aktiva mesatare                                                                 |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Shpenzimet operative / të ardhurat totale të rregullta                                                      |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |
| Korrigjimi i vlerës dhe rezerva e veçantë/ neto- të ardhurat neto nga interesi                              |                                            |           |           |           |            |                                            |           |           |           |            |

#### Legjenda (renditjet në përqindje):

|                   |  |                                                                                                                                                 |
|-------------------|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 0- 10 përqindje   |  | Niveli historikisht i lartë i rrezikut - niveli i realizuar i rrezikut është ndër 10% nivelet më të këqija të realizuara në 5/10 vitet e fundit |
| 10- 20 përqindje  |  | Niveli i realizuar i rrezikut është ndër 10% dhe 20% nivelet më të këqija të realizuara në 5/10 vitet e fundit                                  |
| 20- 40 përqindje  |  | Niveli i realizuar i rrezikut është ndër 20% dhe 40% nivelet më të këqija të realizuara në 5/10 vitet e fundit                                  |
| 40- 60 përqindje  |  | Niveli i realizuar i rrezikut është ndër 40% dhe 60% nivelet më të këqija (ose më të mira) të realizuara në 5/10 vitet e fundit                 |
| 60- 80 përqindje  |  | Niveli i realizuar i rrezikut i realizuar është ndër 20% dhe 40% nivelet më të mira të realizuara në 5/10 vitet e fundit                        |
| 80- 90 përqindje  |  | Niveli i realizuar i rrezikut i realizuar është ndër 10% dhe 20% nivelet më të mira të realizuara në 5/10 vitet e fundit                        |
| 90- 100 përqindje |  | Niveli historikisht i ulët i rrezikut - niveli i realizuar i rrezikut është ndër 10% nivelet më të mira të realizuara në 5/10 vitet e fundit    |

\* Përkatësia në renditjen e përqindjes përcaktohet në bazë të një serie tremujore të të dhënave për treguesit e 10 viteve të fundit (nga 1.1.2014 deri më 31.12.2023).

\*\* Përkatësia në renditjen e përqindjes përcaktohet në bazë të një serie tremujore të të dhënave për treguesit e 5 viteve të fundit (nga 1.1.2019 deri më 31.12.2023).

Harta e "nxehtësisë" për stabilitetin e sistemit bankar mbulon pesë komponentë: rrezikun e falimentimit, rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit, rreziqet e tregut dhe profitabilitetin.



Për secilin nga komponentët, llogaritet një shumë e vlerave të normalizuara të treguesve të zgjedhur, duke përdorur të ashtuquajturën metodë të normalizimit empirik për një seri tremujore të dhënash nga dhjetë vitet e fundit (1.1.2014 – 31.12.2023) dhe pesë vitet e fundit (1.1.2019 – 31.12.2023). Më pas, për vlerat totale të llogaritura për secilin nga komponentët, për çdo datë përcaktohet përkatësia në renditjen e përqindjes përkatëse (parashikohen shtatë renditje përqindjeje). Një ngjyrë e veçantë ofrohet për çdo renditje të përqindjes dhe ngjyrimi ndryshon nga e gjelbra (e cila analizuar historikisht përgjigjet me nivelet më të ulëta të rrezikut) në të kuqen (e cila analizuar historikisht përgjigjet me nivele më të larta të rrezikut). Për krijimin e hartave të paraqitura të "nxehtësisë" janë marrë parasysh 22 tregues, të shpërndarë sipas komponentëve të veçantë.

**Treguesit e paraqitur në hartën e "nxehtësisë" analizohen në një kontekst historik, domethënë, ngjyrat për secilin tregues në një datë të caktuar përcaktohen në mënyrë krahasuese, duke marrë parasysh lëvizjen e treguesit në 5 ose 10 vitet e fundit. Në të njëjtën kohë, ngjyrimet e kuqe për disa nga treguesit nuk duhet të interpretohen në lidhje me cenueshmërinë aktuale më të rëndësishme të sistemit që mund të shkaktojë jostabilitet sistemor, por vetëm se këta tregues, në data të veçanta tremujore, nga viti 2023 arritën nivele që janë paksa më të dobëta në raport me lëvizjet në 5 ose 10 vitet e fundit.**

Aftësia e pagesës e sistemit bankar po përmirësohet edhe gjatë vitit 2023 dhe është në një nivel historik të lartë. Kështu, në data të caktuara tremujore nga viti 2023, të gjithë treguesit e analizuar të rrezikut të falimentimit arritën në nivele historike të larta të analizuara për pesë dhe dhjetë vitet e fundit, ndërkaj në fund të vitit, thuajse të gjithë treguesit e këtij rreziku janë në "zonën e gjelbër".

Treguesit e rrezikut të likuiditetit janë përmirësuar në vitin 2023 dhe në fund të vitit, thuajse të gjithë treguesit janë në "zonën e gjelbër". Pas reduktimit të mjeteve likuide në vitin 2022 dhe tremujorit të parë të vitit 2023, aktiviteti depozitues u forcua, i cili, duke ngadalësuar rritjen e kredive, mundësoi një rritje më të ndjeshme të aktives likuide në vitin 2023 dhe përmirësimin e treguesve të rrezikut të likuiditetit.

Treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor qëndruan në një nivel historik të ulët dhe thuajse të gjithë e mbyllën vitin në "zonën e gjelbër". Në fund të vitit 2023, treguesi i pjesëmarrjes së kredive me probleme në totalin e kredive ra në nivelin më të ulët historik, ngjashëm me treguesin e rrezikshmërisë mesatare të ekspozimit ndaj kredive.

Ndër treguesit e rrezikut të tregut dhe rrezikut të tërthortë kreditor, vetëm pjesëmarrja e pozicionit të hapur valutor në mjetet e veta shënoi rritje me bazë vjetore dhe më 31.12.2023 është në "zonën e kuqe". Pavarësisht rritjes, niveli i këtij treguesi është dukshëm nën kufirin e përcaktuar. Treguesit e tjerë nga ky komponent shënojnë përmirësim në bazë vjetore ose mbetën në nivel relativisht të ngjashëm me datën 31.12.2022.

Treguesit e profitabilitetit janë në një nivel historik të lartë, të analizuar për pesë dhe dhjetë vitet e fundit. Kështu, të gjithë treguesit e këtij komponenti janë në "zonën e gjelbër", gjatë datave individuale tremujore nga viti 2023.



## Raport i rreziqeve në sistemin bankar për vitin 2023

Në vazhdim të Raportit shpjegohen në mënyrë të hollësishme lëvizjet e treguesve të ekspozimit ndaj rreziqeve individuale.



## 1. Rreziku kreditor

Në vitin 2023, përkundër mjedisit të pasigurt dhe shtrëngimit të kushteve financiare, cilësia e portofolit kreditor të sistemit bankar maqedonas vazhdon të jetë solid. Kreditë me probleme janë thuajse të pandryshuara në bazë vjetore, pra u rritën për vetëm 0,2%. Në të njëjtën kohë, bankat vijnë të ofrojnë mbështetje kreditore, por dy herë më ngadalë, krahasuar me një vit më parë, me normën e kredive me probleme të reduktuara në nivelin më të ulët historik prej 2,8%. Nga këndvështrimi sektoral, kreditë me probleme të amvisërive janë në rritje, megjithëse norma e kredive me probleme është në nivele të qëndrueshme (1,9% më 31.12.2023). Në të njëjtën periudhë, kreditë me probleme të ndërmarrjeve shënuan rënie (që vihet re më shumë në aktivitetet e "tregtisë me shumicë dhe pakicë" dhe të "transport-magazinimit"), duke ulur kështu pjesëmarrjen e tyre në totalin e kredive në fund të vitit 2023 në nivelin 3,7%. Krahas nivelit të qëndrueshëm të kredive me probleme, mbulimi relativisht i lartë i këtyre kredive është ruajtur nëpërmjet zhvlerësimit për humbjet e pritshme kreditore. Në fakt, pjesa e parëzervuar e kredive me probleme zë vetëm 3,8% të mjeteve të veta dhe një të katërtën e fitimit të realizuar për vitin 2023, që kufizon rreziket e mundshme për aftësinë e pagesës të sistemit bankar në rast të totalit të supozuar të mospagesës së kredive me probleme.

Në pjesën tjetër të aspekteve të analizuara të portofolit kreditor nuk vërehen shenja të dukshme të përkeqësimit të cilësisë. Normat e kalimit nga kategoria e rrezikut "A" në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C me status të rregullt" shënojnë ulje në vitin 2023. Një përkeqësim i lehtë vjetor vërehet në pjesëmarrjen e kredive të rregullta ku ka një vonesë prej të paktën një detyrimi kontraktual të paguar dhe të paplotësuar në totalin e kredive të rregullta të subjekteve jofinanciare, e cila arriti në nivelin 8%, kundrejt 7,7% në fundi i vitit 2022. Kreditë e zgjatura dhe ato të ristrukturuara, të cilat janë kryesisht pjesë e portofolit kreditor të korporatave, shënuan një ngadalësim të rritjes, përkatësisht rënie dhe nuk paraqesin burim të konsiderueshëm rreziku për një përkeqësim më të theksuar të cilësisë së portofolit kreditor të sistemi bankar vendas, për shkak të pjesëmarrjes së tyre relativisht të ulët në totalin e kredive (4,1%, përkatësisht 1,9% më 31.12.2023). Së fundi, rezultatet e simulimeve të testit të stresit, të kryera për rrezikun kreditor, tregojnë një rezistencë të kënaqshme të sistemit bankar ndaj përkeqësimeve relativisht ekstreme të rrezikshmërisë së portofolit kreditor. Megjithatë, për shkak të rreziqeve aktuale nga mjedisi i pasigurt dhe në ndryshim, si dhe mbajtjes së politikës së shtrënguar monetare dhe përkeqësimit të kushteve financiare globale, bankat duhet të vazhdojnë të jenë të kujdesshme në përcaktimin e humbjeve të pritshme kreditore dhe në përgjithësi në menaxhimin e rrezikut kreditor.

Nga 1.7.2023 filloi zbatimi i masave makroprudenciale për cilësinë e kërkesës për kredi nga personat fizikë, të cilat kufizuan sasinë e treguesve DSTI<sup>11</sup> (në 55% kur miratohet kredia në denarë dhe 50% kur miratohet kredia me komponent valutor)

<sup>11</sup> DSTI është një tregues i raportit ndërmjet detyrimeve të shlyerjes në bazë të kredive dhe të të hyrave të personave fizikë në baza mujore.



dhe LTV<sup>12</sup> (85% kur miraton një kredi të siguruar me pasuri të paluajtshme). Masat e marra ndikojnë në cilësinë e kërkesës për kredi nga personat fizikë, për të parandaluar tejkalimin e borxhit të personave fizikë individualë në kushtet e rritjes së nivelit të çmimeve dhe të rritjes së normave të interesit. Këto masa parandalojnë akumulimin e rreziqeve sistimore në segmentin e amvisërive, të cilat mund të realizohen në formën e humbjeve nga kreditë në banka. Nga të dhënat e marra nga bankat rezulton se lartësia e zbatuar e treguesve DSTI dhe LTV është në nivelin relativisht të matur dhe më 31.12.2023 janë mesatarisht 34,3%, përkatësisht 67%.

Nga fillimi i vitit 2024 është në fuqi Vendimi i ri për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut kreditor<sup>13</sup>, që përputhet më tej me kërkesat rregullatore të zbatuara në Bashkimin Europian dhe kontribuon në forcimin e mëtejshëm të stabilitetit të sistemit bankar. Vendimi përcaktoi një mënyrë të re të vërtetimit të ekspozimeve kreditore me probleme, forcoi kriteret e monitorimit dhe të kontrollit të cilësisë së portofolit kreditor të bankave, si dhe përmirësoi rregullat e ristrukturimit të ekspozimeve kreditore të bankave. Ndryshimet metodologjike në vërtetimin e kredive me probleme<sup>14</sup> do të kontribuojë në rritjen e tyre, të paktën në periudhën fillestare pas zbatimit të vendimit, që është më shumë efekt i qasjes së ndryshme në përcaktimin e statusit jofunksional (në numërimin e ditëve të vonësës), sesa i ndryshimit të aftësisë kreditore të klientëve. Prandaj është e rëndësishme që kredimarrësit të jenë të vetëdijshëm për këto ndryshime rregullatore, në mënyrë që të jenë të rregullt në shlyerjen e detyrimeve dhe të mos e vështirësojnë qasjen e tyre në kredi nga bankat në të ardhmen.

### 1.1. Realizimi i rrezikut kreditor në bilancet e bankave

Në vitin 2023, gjithsej kreditë me probleme të sektorit jofinanciar u rritën për minimalisht 0,2% (ose për 27 milionë denarë)<sup>15</sup>, kundrejt rënies në vitin pararendës. Në të njëjtën kohë, në shumicën e bankave vërehet një rritje vjetore e kredive me probleme. Pavarësisht lëvizjeve të tilla modeste vjetore në nivelin e kredive me probleme, **është e nevojshme të monitorohet vazhdimisht dhe me kujdes aftësia kreditore e klientëve, veçanërisht e atyre që aktualisht kanë një nivel më të lartë të borxhit dhe janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në mjedis.**

<sup>12</sup> LTV është një tregues i raportit ndërmjet masës së ekspozimit kreditor të personave fizikë dhe vlerës së pasurisë së paluajtshme të lënë peng.

<sup>13</sup> I disponueshëm në këtë vjeggëz: [https://www.nbrm.mk/content/Regulativa/Odluka\\_metodologija\\_%20za\\_kreditin\\_rizik\\_nova.pdf](https://www.nbrm.mk/content/Regulativa/Odluka_metodologija_%20za_kreditin_rizik_nova.pdf)

<sup>14</sup> Efekti i parë i njehershëm në janar 2024 është rritja e kredive me probleme për rreth 12%, si në bazë vjetore, ashtu edhe mujore.


<sup>15</sup> Duke veçuar efektin e fshirjeve neto, kreditë me probleme të sektorit jofinanciar shënuan rritje prej 2,9% (ose për 1,158 milionë denarë). Termi "fshirje neto të detyrueshme" përfshin shumën e fshirjeve për shlyerjen e fshirjeve të bëra më parë. Në përputhje me rregulloren, duke filluar nga mesi i vitit 2019, çdo bankë është e detyruar të kryejë një fshirje të detyrueshme të ekspozimeve kreditore kur kanë kaluar 12 muaj nga data kur banka ishte e detyruar të kryente një zhvlerësim të plotë, pra të lërë mënjanë një rezervë të veçantë. Në periudhën nga viti 2016 deri më 1 korrik 2019, bankat ishin të detyruara të kryenin një fshirje të detyrueshme të ekspozimeve kreditore për të cilat kanë kaluar njëzet e katër muaj nga data kur ka pasur detyrimin për të bërë një zhvlerësim të plotë, përkatësisht veçim të një rezerve të posaçme.



Grafiku nr. 11

Ndryshimi vjetor i kredive me probleme të subjekteve jofinanciare (majtas) dhe shuma dhe struktura sektorale e kredive me probleme (djathtas)

në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka Popullore dhe Regjistri i Kredive në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Vijat me pika tregojnë dinamikën e kredive me probleme duke përjashtuar efektin e të gjitha fshirjeve të detyrueshme. Duke filluar nga dhjetori i vitit 2019, të dhënat përfshijnë edhe kreditë e shlyera të fshira detyrimisht.

**Për të tretin vit radhazi, ka një rritje të caktuar të portofolit kreditor jofunksional të amvisërive.** Rritja e kredive me probleme të amvisërive është e ngjashme me vitin e mëparshëm dhe është rreth 140 milionë denarë (pra 3,4%)<sup>16</sup> dhe në pjesën më të madhe rezulton nga kreditë me probleme të personave fizikë për financimin e konsumit<sup>17</sup>. Gjithashtu, kreditë me probleme të personave fizikë për financimin e blerjes së hapësirës banesore dhe afariste në vitin 2023 u rritën për 8,9 % (d.m.th. për 34 milionë denarë), si dhe u rritën edhe kreditë me probleme të shitësve me pakicë (për rreth 3 milionë denarë).

<sup>16</sup> Nëse përjashtohet efekti i fshirjeve të detyrueshme neto, kreditë me probleme të amvisërive shënuan një rritje vjetore prej 8,5%, që është pak më e lartë, krahasuar me një vit më parë (8,2%).


<sup>17</sup> Kreditë me probleme për financimin e konsumit u rritën për 3%, përkatësisht për 111 milionë denarë. Kjo kryesisht erdhi si pasojë e rritjes së kredive konsumatore me probleme për 117 milionë denarë, pra me një rritje të vogël prej 18 milionë denarë të produktet e tjera kreditore (kredi për vetura dhe kredi të tjera), ndërsa kreditë me probleme në mbiterheqjet e lejuara në llogaritë e pagesave dhe kreditë e bazuara në karta krediti u ulën për 24 milionë denarë.



Grafiku nr. 12

Shpërndarja e ndryshimit absolut vjetor (majtas) dhe ndryshimit relativ (djathtas) i kredive me probleme të shoqërive jofinanciare sipas aktiviteteve të përzgjedhura dhe i amvisërive sipas produkteve individuale kreditore.

në milionë denarë (majtas) dhe në përqindje (djathtas)



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Termi "sektor ndërtimi" përfshin veprimtaritë "ndërtim" dhe "aktivitete që lidhen me pasuritë e paluajtshme", termi "aktivitet hotelierie" u referohet "mjediseve të akomodimit dhe aktiviteteve të shërbimit ushqimor", ndërsaq termi "hua për personat fizikë për financimin e konsumit" u referohet kredive konsumatore, mbiterheqjeve të lejuara, kartave të kreditit, kredive për makina dhe kredive të tjera të personave fizikë. Termi "kredi për financimin e konsumit" përfshin kreditë konsumatore, kreditë për makina, mbiterheqjet në llogaritë e pagesave dhe kreditë e bazuara në karta krediti dhe kredi të tjera.

**Kundrejt lëvizjeve të sektorit të "amvisërisë", kreditë me probleme të sektorit të korporatave<sup>18</sup> në vitin 2023 u ulën për 2,8%, përkatësisht për 220 milionë denarë<sup>19</sup>.**

Rënie të kredive me probleme ka në pjesën më të madhe të aktiviteteve ekonomike individuale, me përjashtim të aktiviteteve të "industrisë", "ndërtimit" dhe "bujqësisë", ndërsa nxitësi më i rëndësishëm për rënien vjetore është aktiviteti i "tregtisë me shumicë dhe me pakicë" (549 milionë denarë ose 24,4%) dhe "transportit dhe magazinimit" (209 milionë denarë ose 33%).

**Në lëvizjet e këtyre kredive në vitin 2023 nduan edhe fshirjet e detyrueshme të kredive me probleme.** Në vitin 2023 u bënë fshirje të detyrueshme në vlerë prej 1.906 milionë denarë, që është shumë e ngjashme me vitin e kaluar (1.951 milionë denarë), me të cilat në fund të vitit 2022 u shlyen praktikisht 15,6% të kredive me probleme. Nga këndvështrimi i sektorit, për të dytin vit radhazi, bankat fshijnë më shumë kredi me probleme të amvisërive, krahasuar me ato të shoqërive jofinanciare (pjesëmarrje prej 57,8% në totalin e fshirjeve të detyrueshme).

**Shlyerja e kredive me probleme nëpërmjet marrjes së kolateralit ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e rritjes së konsiderueshme të kredive me probleme në vitin 2023.** Konkretisht, në tremujorin e fundit të vitit, një shumë e konsiderueshme e kërkesave

<sup>18</sup> Pavarësisht reduktimit, kreditë me probleme të korporatave vazhdojnë të mbizotërojnë në totalin e portofolit me probleme me një pjesëmarrje prej 63,5% në fund të vitit 2023 (65,5% më 2022).


<sup>19</sup> Nëse përfshihet efekti i fshirjeve të detyrueshme neto, kreditë me probleme të ndërmarrjeve shënuan një rritje minimale vjetore prej 0,2%.



nga një klient kryesor morën status jofunksional<sup>20</sup> dhe më pas u mbyll me konfiskimin e pronës së lënë peng. Kështu, vlera e mjeteve të marra gjatë vitit 2023 (3.680 milionë denarë) është 28,4% e ekspozimit jofunksional në fund të vitit 2022, që është shumë më shumë në krahasim me vitin e kaluar (kur ishte 3,3% e ekspozimit jofunksional në fund të vitit 2021).

Grafiku nr. 13

Shkalla e kredive me probleme të subjekteve jofinanciare dhe sipas sektorëve individualë



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Vijat me pika tregojnë mesataret dhjetëvjeçare të shkallës së kredive me probleme (majtas) dhe të shkallës së ekspozimit me probleme (djathtas), e llogaritur duke përfshirur efektin kumulativ të të gjitha fshirjeve të detyrueshme dhe mbledhjen kumulative të fshirjeve të kryera më parë (duke filluar nga dhjetori 2019). Mesatarja dhjetëvjeçare llogaritet në bazë të një sërë të dhënash me frekuencë tremujore.

**Rritja minimale e kredive me probleme në vitin 2023, me rritjen e mëtejshme, por më të ngadaltë të aktivitetit kreditor të bankave në krahasim me vitin e kaluar<sup>21</sup>, kontribuoi në uljen e shkallës së kredive me probleme në nivelin më të ulët historik prej 2,8%, e cila është më e ulët për 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2022.** Raporti i kredive me probleme është në rënie me bazë vjetore dhe nëse përjashtohet efekti i fshirjeve të detyrueshme neto (8,8% në fund të 2023 dhe 9% më 2022), që është gjithashtu niveli më i ulët i normave të arritura në dhjetë vitet e fundit dhe vazhdon të jetë nën mesataren e saj dhjetëvjeçare prej 10,6%.


<sup>20</sup> Po të mos ishte shlyer, kjo kredi e re me probleme do të kishte rritur raportin e kredive me probleme të sektorit të korporatave për pak më shumë se 1 p.p.

<sup>21</sup> Totali i kredive të subjekteve jofinanciare u rrit për 4,3% me bazë vjetore (kundrejt 10,1% në vitin 2022).



Grafiku nr. 14

Shkalla e kredive me probleme të shoqërive jofinanciare, sipas aktivitetit (majtas) dhe sipas madhësisë së huamarrësve (djathtas) në përqindje




Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore dhe të dhënat e ofruara nga bankat, sipas kërkesës së posaçme të Bankës Popullore

**Nga aspekti i sektorit, rënie e shkallës së kredive me probleme në vitin 2023 vërehet vetëm në sektorin e korporatave, për 0,2 pikë përqindjeje (nga 3,9% në 3,7%)<sup>22</sup>.** Njëkohësisht, rënie e shkallës së kredive me probleme vërehet në shumicën e aktiviteteve më të rëndësishme të shoqërive jofinanciare, me përjashtim të aktivitetit të "industrisë", i cili u rrit mesatarisht në nivelin 4,3% (3,7% më 2022). Nga aspekti i madhësisë së shoqërive jofinanciare<sup>23</sup>, në vitin 2023, shkalla e kredive me probleme zvogëlohet te ndërmarrjet e mëdha dhe rritet te ndërmarrjet e mesme, të vogla dhe mikro.

Grafiku nr. 15

Shkalla e kredive me probleme sipas produkteve individuale të kredisë të personave fizikë në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

<sup>22</sup> Nëse përjashtohet efekti i fshirjeve të detyrueshme neto, shkalla e kredive me probleme në këtë sektor gjithashtu ulet dhe do të ishte 12,3%, që është nën mesataren e saj dhjetëvjeçare (15,5%).

<sup>23</sup> Kriteret e klasifikimit të subjekteve në tregtarë të mëdhenj, të mesëm, të vegjël dhe mikro janë dhënë në nenin 470 të Ligjit të Shoqërive Tregtare.




**Për dallim nga sektori i korporatave, shkalla e kredive me probleme të sektorit të "amvisërisë" është e pandryshuar në baza vjetore dhe është në fund të vitit 2023 është 1,9%<sup>24</sup>. Ky tregues shënon rënie në pjesën më të madhe të produkteve kreditore, ndërkohë që norma më e ulët e kredive me probleme vazhdojnë të jenë kreditë e paracaktuara për blerjen e pasurisë së paluajtshme.**

**Analiza e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor, krahas prirjeve të kredive me probleme, përfshin edhe disa aspekte të portofolit kreditor, të cilat në vitin 2023, kryesisht nuk japin bazë për një përkeqësim të ndjeshëm të cilësisë së tij në të ardhmen.** Kështu, tregues të dobishëm të paralajmërimit të hershëm për rrezikun kreditor janë treguesit që monitorojnë nivelin e vlerësuar të rrezikut nga bankat në kuadër të ekspozimit kreditor me status të rregullt. Në vitin 2023, pjesëmarrja e ekspozimit me status të rregullt, i cili ka një cilësi më të ulët kreditore, u ul<sup>25</sup> (të klasifikuar në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C të rregullt") në totalin e ekspozimit të rregullt kreditor ndaj subjekteve jofinanciare nga 12,6% në 11,8%, që është regjistruar në të dy sektorët (pjesëmarrja në ekspozimin ndaj sektorit të amvisërisë u ul për 0,6 pikë përqindje, kurse ndaj shoqërive jofinanciare për 0,9 pikë përqindje). Megjithatë, ky tregues në portofolin e përbërë nga amvisëritë vazhdon të jetë më i lartë se mesatarja e tij në dhjetë vitet e fundit.

Grafiku nr. 16

Treguesit e paralajmërimit të hershëm për nivelin e rrezikut brenda ekspozimit të rregullt kreditor të bankave ndaj subjekteve jofinanciare (majtas) dhe hendekut midis kredive të rregullta në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C" dhe kredive me probleme\*, të pasqyruar sipas pjesëmarrjes së tyre në totalin e kredive (djathtas)



në përqindje

në përqindje të totalit të kredive

Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Mesatarja dhjetëvjeçare e treguesve llogaritet në bazë të frekuencës tremujore të të dhënave dhe paraqitet me vijë të ndërprerë.

\* Kreditë e rregullta të klasifikuara në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C" dhe kreditë me probleme janë një përafrim i të ashtuquajturave kredi nga grupet 2, përkatësisht 3 sipas SNRF 9.


<sup>24</sup> Duke përjashtuar efektin e shirjeve të detyrueshme neto, edhe shkalla e kredive me probleme të amvisërive është e pandryshuar dhe është 5,4%, që është pothuajse në të njëjtin nivel me mesataren e saj dhjetëvjeçare.

<sup>25</sup> Ekspozimet ndaj rrezikut kreditor që, në përputhje me rregulloren, klasifikohen në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C të rregullt" mund të konsiderohen si një përafrim për ekspozimet që, në përputhje me SNRF 9 - instrumentet financiare, përfshihen në të ashtuquajturat aktivet financiare të grupit 2 që konsiderohen të kenë një përkeqësim të konsiderueshëm të cilësisë së kredisë pas njohjes fillestare në regjistrat kontabël, por ende nuk kanë shenja objektive të zhvlerësimit, pra për t'u përfshirë në të ashtuquajturat aktivet financiare të grupit 3.



**Shkallët vjetore të kalimit brenda ekspozimit të rregullt kreditor shënuan gjithashtu një rënie në vitin 2023<sup>26</sup>.** Normat e tranzicionit brenda ekspozimit të rregullt kreditor (kalimi nga kategoria e rrezikut "A" në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C e rregullt") shënuan rënie në vitin 2023 dhe janë nën mesataren e tyre dhjetëvjeçare. Kjo tregon se bankat brenda portofolit të rregullt kreditor perceptuan një ulje të rrezikut kreditor, pra vlerësuan se palët kreditore që formojnë ekspozimin e rregullt kreditor përjetuan një përmirësim të caktuar të aftësisë kredituese pas miratimit të ekspozimit. Dhe normat vjetore të kalimit nga ekspozimi i rregullt në jofunksional janë kryesisht nën mesataren e tyre dhjetëvjeçare. Përfundimisht i vetëm nga kjo është shkalla e kalimit nga ekspozimi i rregullt në ekspozimin jofunksional të amvisërive, të cilat në vitin 2023 shënuan rritje, e cila u ngadalësua dhe është minimalisht mbi mesataren e saj dhjetëvjeçare.

Grafiku nr. 17 Shkallët vjetore të kalimit në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Mesatarja dhjetëvjeçare e shkallëve të kalimit llogaritet në bazë të frekuencës tremujore të normave vjetore përkatëse të kalimit dhe tregohet me vijën e ndërprerë. Në përlogaritjen e normave të kalimit sipas numrit të palëve, shkallët e totalit të subjekteve jofinanciare nuk janë paraqitur sepse janë pothuajse identike me shkallët e kalimit të amvisërive, që vjen si pasojë e pjesëmarrjes mbizotëruese të këtij sektori në numrin total të palëve kreditore në nivel të sistemit bankar (93,7% në fund të vitit 2023, përkatësisht 93,4% në fund të 2022).

**Bankat ruajnë një mbulim të lartë të kredive me probleme nëpërmjet zhvlerësimit të veçantë.** Në fakt, 70,1% e shumës bruto të kredive me probleme mbulohet

<sup>26</sup> Shkallët vjetore të kalimit llogariten për shumën e ekspozimit dhe numrin e palëve kreditore në fund të çdo viti në vitin vijues kalendarik, përkatësisht: nga statusi i rregullt në atë jofunksional dhe nga kategoria e rrezikut "A" në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C me status të rregullt". Shkallët e kalimit mund të konsiderohen si një lloj përafrimi për shkallët e mospagimit (ang. "default ratës").




nëpërmjet zhvlerësimit, që është një rritje prej 0,7 pikë përqindjeje, krahasuar me një vit më parë.

**Bankat ruajtën pothuajse të njëjtin mbulim të totalit të kredive të rregullta nëpërmjet zhvlerësimit.** Kështu, në fund të vitit 2023, humbjet e pritshme të kredive të përcaktuara për kreditë e rregullta të subjekteve jofinanciare janë në nivelin 2,3%, që është më për 0,1 p.p. më pak, krahasuar me fundin e vitit 2022. Ky reduktim vjen tërësisht nga sektori i korporatave, ndërkohë që një rritje e vogël e humbjeve të pritshme të kredive vërehet te amvisëritë, si për kreditë e rregullta, ashtu edhe për ato me probleme. Bankat vazhdojnë të identifikojnë rreziqe më të larta nga sektori i korporatave pasi humbjet e pritshme të kredive për kreditë e rregullta të shoqërive jofinanciare janë më shumë se tre herë më të larta sesa të amvisërive, si për fundin e vitit 2023, ashtu edhe për mesataren e dhjetë viteve të fundit. Analizuar nga këndvështrimi i aktiviteteve individuale, humbjet e pritshme të kredive (si përqindje e kredive të rregullta) në fund të vitit 2023 janë më të lartat për kreditë e rregullta të sektorit të ndërtimit (4,2%), kurse më të ulëta të "tregtisë me shumicë dhe pakicë" (2,9%), ndërsa rënia më e madhe vjetore (për 2,7 p.p.) në humbjet e pritshme të kredive vërehet në industrinë e hotelierisë. Në produktet kreditore të amvisërive, humbjet e pritshme të kredive janë rritur brenda kredive të rregullta konsumatore dhe mbitërheqjeve dhe kartave të kreditit, ndërsa mbulimi me fshirje të kredive të banesave është më i ulëti (këto kredi priren të jenë të cilësisë më të mirë) dhe nuk ka ndryshuar.

Grafiku nr. 18 Humbje kreditore të pritshme:


- sipas sektorëve të veçantë për kreditë totale (majtas), me probleme (në mes) dhe të rregullta (djathtas)

në përqindje






- për kredi me probleme për aktivitete të përzgjedhura të shoqërive jofinanciare (majtas) dhe për produkte individuale kreditore të amvisërive (djathtas) në përqindje



- për kredi të rregullta për aktivitete të përzgjedhura të shoqërive jofinanciare (majtas) dhe për produkte individuale kreditore të amvisërive (djathtas) në përqindje




Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Vijat e ndërprera në grafikun në të majtë janë mesatarja dhjetëvjeçare e mbulimit të kredive me probleme dhe të zhvlerësuar të rregullta, e llogaritur në bazë të frekuencës vjetore të të dhënave.

**Mbulimi i lartë i kredive me probleme nëpërmjet zhvlerësimit zvogëlon rreziqet për aftësinë e pagesës të bankave në rast të mospagesës së plotë të supozuar të këtyre kredive.** Në fakt, shumica e parazervuar e kredive me probleme, pra vëllimi i humbjeve të papritura të kredive mbi këtë bazë është i ulët dhe ka një ndikim të kufizuar në aftësinë e pagesës të sistemit bankar vendas, pasi që vetëm 3,8% të mjeteve të veta dhe 4% të kapitalit të rregullt bazë në nivel sistemi bankar (krahasuar me vitin e kaluar shënuan një përmirësim prej 0,5, përkatësisht 0,6 pikë përqindjeje). Përveç kësaj, shpenzimet e mundshme shtesë të mbulimit të plotë të kredive me probleme nëpërmjet zhvlerësimit do të merrte vetëm një të katërtën e fitimit të realizuar për vitin 2023. Kjo do të thotë se edhe në rastin e një supozimi kaq ekstrem të rezervimit të plotë të nivelit aktual të kredive me probleme, aftësia e pagesës dhe profitabiliteti i sistemit bankar nuk do të kërcënohej, pra nuk do të rrezikohej stabiliteti i sistemit bankar.



Grafiku nr. 19 Rëndësia relative e pjesës së kredive me probleme që nuk mbulohet nëpërmjet zhvlerësimit në raport me mjetet e veta dhe kapitalin bazë të rregullt (majtas) dhe rezultatin financiar (djathtas) në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Një tregues tjetër i cilësisë së portofolit kreditor të bankave është pjesëmarrja e kredive me të paktën një detyrim kontraktual të skaduar dhe të paplotësuar.** Ky tregues pasqyron potencialin për një përkeqësim të mundshëm të cilësisë së kredive në afat të shkurtër. Te kreditë ku vonesa është më e gjatë se 31 ditë<sup>27</sup>, por deri në 90 ditë janë vetëm 0,9% e kredive të rregullta, bankat sigurojnë një mbulim më të lartë nëpërmjet zhvlerësimit, krahasuar me totalin e portofolit të rregullt kreditor.

Grafiku nr. 20 Rëndësia relative e kredive të rregullta të vonuara (majtas), rrezikshmëria mesatare e kredive të rregullta të vonuara (në mes) dhe pjesëmarrja e kredive të rregullta të vonuara mbi 31 ditë në totalin e kredive të rregullta (djathtas) në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.


Vërejtje: Mesatarja dhjetëvjeçare e nivelit mesatar të rrezikut llogaritet në bazë të frekuencës vjetore të të dhënave dhe tregohet me vijën e ndërprerë.

<sup>27</sup> Pikërisht kreditë që kanë një vonesë më shumë se 31 ditë, në rast të zgjatjes së vonesës, mund të jenë burimi kryesor i rritjes së ardhshme të kredive me probleme, duke pasur parasysh se kreditë me vonesë mbi 90 ditët klasifikohen si kredi me probleme.



**Një segment tjetër i portofolit kreditor që kërkon monitorim më të kujdesshëm janë kreditë e ristrukturuara,** sepse ristrukturimi, si rregull, kryhet për kërkesat e klientëve që kanë një situatë të përkeqësuar financiare dhe është e nevojshme të rregullohet barra e tyre kreditore. Pas rritjes fillestare të lartë të ristrukturimeve në vitin pandemik 2021, në vitin 2023, kreditë e rregullta të ristrukturuara u ulën ndjeshëm (rënie prej 33,8%), kurse kreditë me probleme të ristrukturuara u rritën lehtë (ritje për 0,4%). Analizuar sipas sektorëve, shoqëritë jofinanciare kanë pjesëmarrjen më të madhe prej 92,8% në strukturën e portofolit kreditor të ristrukturuar<sup>28</sup>.

Grafiku nr. 21 Shuma absolute dhe ndryshimi vjetor (majtas) dhe treguesit e rëndësisë relative të kredive të ristrukturuara të subjekteve jofinanciare (djathtas) në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Mesatarja dhjetëvjeçare e treguesve të rëndësisë relative të kredive të ristrukturuara llogaritet në bazë të frekuencës tremujore të të dhënave dhe tregohet me vijë të ndërprerë.


**Përfaqësimi i kredive të ristrukturuara në total dhe në kreditë e rregullta është shumë i vogël dhe është ulur më tej në vitin 2023 dhe është 1,9%, përkatësisht 1%.** Bankat perceptojnë një rrezik më të lartë nga këto kredi, duke lënë mënjandë humbjet më të larta të pritshme kreditore për to. Kështu, mbulimi i kredive të rregullta të ristrukturuara nëpërmjet zhvlerësimit në vitin 2023 është 21,6% dhe është dukshëm më i lartë se mbulimi i totalit të kredive të rregullta, që është 2,3%<sup>29</sup>. Përkundër kësaj, mbulimi i kredive me probleme të ristrukturuara me rezervime të veçuara (prej 64,8%) është i ngjashëm me mbulimin e totalit të kredive me probleme (prej 70,1%).

<sup>28</sup> Më 31.12.2023, në portofolet kreditore të personave juridikë dhe të amvisërive, kreditë e ristrukturuar marrin pjesë me 3,6%, përkatësisht 0,3%.

<sup>29</sup> 21,2%, përkatësisht 2,4% në fund të vitit 2022.




Grafiku nr. 22 Treguesit e rëndësisë relative (majtas) dhe të rrezikshmërisë së kredive të ristrukturuara sipas sektorëve (djathtas) në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 23 Shuma absolute dhe ndryshimi vjetor (majtas) dhe treguesit e rëndësisë relative të kredive të zgjatura të subjekteve jofinanciare (djathtas) në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.


Vërejtje: Mesatarja dhjetëvjeçare e treguesve të rëndësisë relative të kredive të zgjatura llogaritet në bazë të frekuencës tremujore të të dhënave dhe paraqitet me vijë të ndërprerë.

**Zakonisht, zgjatja e maturimit bëhet për klientët që nuk përballen me vështirësi financiare dhe bëhet me qëllim të rinovimit të kredive ose harmonizimit të afatit të maturimit me kornizën për një marrje përsipër të caktuar biznesi ose të ngjashme.** Zgjatja e kredive mund të jetë një burim potencial rreziku nëse përdoret si një mënyrë për të lehtësuar barrën financiare të shoqërive jofinanciare që nuk kanë flukse monetare të qëndrueshme operative ose kanë vështirësi në ruajtjen e aftësisë së tyre konkurruese në treg. **Në vitin 2023 ka një ngadalësim, por rritja e kredive të zgjatura vazhdon të jetë dyshifrore.** Kështu, gjithsej kreditë e zgjatura u rritën për 10,1%, përkatësisht për 1.647 milionë denarë në bazë vjetore, që është më pak si në shuma absolute, ashtu edhe relative në krahasim me vitin 2022 (rritje për 16,7% dhe 2.332 milionë denarë). Struktura e tyre është e pandryshuar,



pra vazhdojnë të mbizotërojnë kreditë e zgjatura të rregullta (pjesëmarrje prej 95,2%) dhe sipas sektorit, kreditë e shoqërive jofinanciare zgjaten më shumë (91,4%). **Përfaqësimi i kredive të zgjatura në totalin e portofolit kreditor të bankave aktualisht nuk është i madh, që kufizon efektet anësore të mundshme të realizimit të këtij rreziku.**

Grafiku nr. 24 Treguesit e rëndësisë relative (majtas) dhe të rrezikshmërisë (djathtas) të kredive të zgjatura, sipas sektorëve individualë në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.


Vërejtje: Mesatarja dhjetëvjeçare e treguesve të rëndësisë relative të kredive të zgjatura llogaritet në bazë të frekuencës tremujore të të dhënave dhe paraqitet me vijë të ndërprerë.

**Në vitin 2023, bankat vlerësuan një rrezik më të ulët kreditor nga kreditë e zgjatura, krahasuar me një vit më parë, i cili është më i lartë krahasuar me totalin e portofolit të rregullt kreditor. Kështu, rrezikshmëria mesatare e kredive të zgjatura për të gjithë sektorin jofinanciar është 6,7%, duke shënuar një rënie vjetore prej 0,6 pikë përqindjeje dhe është në nivelin më të ulët të mesatares së saj dhjetëvjeçare (9,6%).**

**Ekspozimi i sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor analizohet edhe në aspektin e përqendrimit të ekspozimit, i cili mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në vëllimin dhe shpejtësinë e realizimit të rrezikut kreditor. Në vitin 2023, pjesa më e madhe e treguesve me të cilët gjurmohet përqendrimi i ekspozimit shënuan rënie në bazë vjetore.** Konkretisht, pjesëmarrja e dhjetë ekspozimeve më të mëdha të secilës bankë ndaj subjekteve jofinanciare në ekspozimin total ndaj rrezikut kreditor dhe në mjetet e veta është 12,4% dhe 67,6%, që paraqet një rënie prej 0,5 dhe 6,1 pikë përqindjeje në mënyrë përkatëse në raport me vitin 2022.




Grafiku nr. 25 Treguesit e përqendrimit të ekspozimit të rrezikut kreditor ndaj subjekteve jofinanciare në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Rënie në bazë vjetore vihet re edhe në nivelin mesatar të rrezikut të dhjetë ekspozimeve më të mëdha, si dhe në pjesëmarrjen e pjesës së tyre të parazervuar në mjetet e veta.

Grafiku nr. 26 Kredi me shlyerje njëhershme të kryegjësë - shuma absolute dhe ndryshimi vjetor (majtas), pjesëmarrja në totalin e kredive sipas sektorëve (në mes) dhe treguesit e rëndësisë së tyre relative (djathtas) në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Mesatarja dhjetëvjeçare e treguesve të rëndësisë relative të kredive me një shlyerje të njëhershme të kryegjësë llogaritet në bazë të frekuencës tremujore të të dhënave dhe tregohet me vijë të ndërprerë.


**Kreditë ku është rënë dakord detyrimi i përdoruesit për një shlyerje të njëhershme të kryegjësë**, gjithashtu mund të paraqesin burimin e mundshëm të kredive për realizimin e rrezikut kreditor. Këto kredi janë dhënë thuajse tërësisht për shoqëritë jofinanciare<sup>30</sup> të cilët zënë rreth një të tretën e totalit të kredive dhe 26,5% të kredive me probleme. Në vitin 2023, në ndryshim nga rritja e vitit të kaluar, kreditë me shlyerje të njëhershme të kryegjësë të

<sup>30</sup> Në fund të vitit 2023, në totalin e kredive ku është rënë dakord një shlyerje njëhershme e kryegjësë, shoqëritë jofinanciare marrin pjesë me 99%, ndërsa pjesëmarrja e amvisërive është vetëm 1%.



shoqërive jofinanciare ranë për 6,6%, ndërsa shkalla e kredive me probleme arriti në 3,4% dhe shënoi një rritje prej 0,2 pikë përqindje në raport me vitin 2022 (nxitëse e së cilës ishin kredimarrësit e sektorit të industrisë). Niveli mesatar i rrezikshmërisë së ekspozimit të bankave në bazë të këtyre produkteve kreditore vazhdon të jetë në nivelin 3,5% dhe është i ngjashëm me rrezikshmërinë mesatare të të gjithë portofolit kreditor të korporatave.

Grafiku nr. 27 Treguesit e kredive të shoqërive jofinanciare për financimin e projekteve në përqindje




Burimi: Të dhëna të ofruara nga bankat në bazë të një kërkesë të posaçme të Bankës Popullore.

**Kreditë e miratuara për financimin e projekteve përfaqësojnë gjithashtu një burim të mundshëm të humbjeve të papritura kreditore sepse** cilësia e tyre varet kryesisht nga vëllimi dhe dinamika me të cilën do të realizoheshin flukset monetare të parashikuara të projekteve të financuara nga këto kredi. Shfrytëzues të kredive të këtilla janë shoqëritë jofinanciare, kryesisht ato me aktivitet mbizotërues të "industrisë" dhe "sektorit të ndërtimit", të cilat së bashku përbëjnë 75,5% të të gjitha kredive të miratuara për financimin e projekteve. Rëndësia e kredive të miratuara për financimin e projekteve për totalin e portofolit kreditor të bankave ndaj shoqërive jofinanciare rritet gradualisht në vitet e fundit dhe në vitin 2023 vihet re një rritje më e ndjeshme në këtë pjesëmarrje deri në 17% (13,3% më 31.12.2022). Cilësia e këtij portofoli është në përmirësim, me një shkallë kredie me probleme në vitet e fundit prej rreth 2%.



Grafiku nr. 28 Pjesa e kredive me probleme (majtas) dhe e kredive të rregullta (djathtas) për të cilat është vendosur kolateral, sipas sektorëve në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Kreditë e miratuara nga bankat kanë një shkallë relativisht të lartë mbulimi me një formë të caktuar kolaterali, si garanci në lidhje me shlyerjen e ardhshme të kredisë.** Në fund të vitit 2023 u krijua një lloj sigurie për 86,7% të kredive me probleme dhe 88,2% të kredive të rregullta. Nga aspekti i sektorit, niveli i mbulimit me kolateral është më i lartë në portofolin kreditor të shoqërive jofinanciare, ku kjo përqindje arrin në 99%, ndërsa në rastin e amvisërive, përqindja e kredive me kolateral është më e ulët (78,7% për kreditë e rregullta dhe 63,5% për kreditë me probleme) kryesisht për shkak të kredive për qëllime konsumatore<sup>31</sup>. Në mesin e vitit 2023 nisën të zbatohen masat makroprudenciale për cilësinë e kërkesës për kredi, kurse ndër të tjera, me ç'rast mes masave të tjera përcaktohet edhe vlera maksimale e raportit ndërmjet shumës së kredisë së personit fizik dhe vlerës së pasurisë së paluajtshme të lënë peng, në nivelin 85%. Bankat janë të kujdesshme, kështu që më 31.12.2023, ky raport për kreditë e miratuara rishtazi për personat fizikë të siguruara me pasuri të paluajtshme është mesatarisht 67% (69,6% për kreditë banesore dhe 59,5% për kreditë hipotekare konsumatore).


Në kuadër të masave makroprudenciale është përcaktuar shuma maksimale e detyrimit mujor për shlyerje në raport me të ardhurat mujore të personit fizik (treguesi DSTI) në lartësinë prej 55% dhe 50%, varësisht nëse kredia është miratuar në denarë ose me një komponent valutë. Bankat zbatojnë një qasje të kujdesshme në kreditimin edhe nga aspekti i këtij treguesi, që mesatarisht është 34,5%. Paketa e masave makroprudenciale përfshin gjithashtu kufizimin e maturimit maksimal të kredive banesore në 30 vjet dhe të kredive hipotekare konsumatore në 20 vjet. Maturimi mesatar i ponderuar<sup>32</sup> i kredive të reja të miratuara banesore tregon një zgjatje minimale krahasuar me vitin 2022 dhe është 19,5 vjet.

<sup>31</sup> Dy të tretat e kredive për financimin e konsumit, në fund të vitit 2023, mbulohen me kolateral të vendosur, që është dukshëm më i vogël në krahasim me kreditë për blerjen e pasurive të paluajtshme, ku thuajse e gjithë shuma e kredive mbulohet me kolateralin e vendosur.

<sup>32</sup> Pjesëmarrja e secilës bankë në kryeqjënë në fund të vitit merret si ponder gjatë përcaktimit të maturimit mesatar të kredive në nivel të sistemit bankar.




Grafiku nr. 29 Maturimi mesatar i ponderuar gjatë miratimit dhe shuma mesatare e anuitetit për kredimarrës për kreditë për blerjen e hapësirës banesore dhe për totalin e kredive konsumatore në vjet (boshti majtas) dhe në milionë denarë (boshti djathtas)



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 30 Struktura e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor për produktet e zgjedhura kreditore të personave fizikë sipas shumës së të ardhurave mujore (majtas) dhe sipas numrit të kredimarrësve (djathtas) në përqindje (majtas) dhe numri i personave (djathtas)




Burimi: Të dhëna të ofruara nga bankat në bazë të një kërkesë të posaçme të Bankës Popullore.

**Në kuadër të strukturës së ekspozimit të bankave ndaj amvisërive sipas sasisë së të ardhurave mujore të kredimarrësve, dallimi vazhdon të shprehen sipas produkteve individuale kreditore.** Në fakt, ata kredimarrës që kanë të ardhura mujore më të larta, përkatësisht me të hyra mujore mbi 50.000 denarë, dhe pjesëmarrja e tyre është 57,8%, zakonisht “kualifikohen” si kredi për blerjen e hapësirës banesore. Nga ana tjetër, te kredimarrësit më të cenueshëm financiarisht, përkatësisht ata me të ardhura mujore nën 30.000 denarë, ka



një përfaqësim më të madh të kredive për financimin e konsumit, me pjesëmarrje prej 44,9% në kreditë konsumatore, ndërsa në të njëjtën kohë gjysma e mbitërheqjeve të lejuara dhe kartat e kreditit u bien pikërisht këtyre klientëve me të ardhura më të ulëta. Mirëpo, në bazë vjetore edhe më tutje ka prirje në rënie të pjesëmarrjes së popullatës me të ardhura deri në 30.000 denarë në secilin prej produkteve kreditore, në kurriz të rritjes së pjesëmarrjes së personave me të ardhura mbi 50.000 denarë.

Grafiku nr. 31 Ekspozimi mesatar për person për produktet e zgjedhura kreditore në milionë denarë



Burimi: Të dhëna të ofruara nga bankat në bazë të një kërkesë të posaçme të Bankës Popullore.

**Niveli mesatar i ekspozimit kreditor të bankave për person ndryshon në varësi të llojit të produktit kreditor, ku është më e larta në mesin e kredive për blerjen e hapësirës banesore, ndërsa numri i përdoruesve të këtyre kredive është më i ulët.**

## 1.2. Testi i stresit të rezistencës së sistemit bankar ndaj rritjes së rrezikut kreditor


**Në fund të vitit 2023, rezultatet e simulimeve të rezistencës së sistemit bankar ndaj rritjes së rrezikut kreditor tregojnë një aftësi solide të sistemit bankar vendas për të përballuar goditjet hipotetike të rritjes së rrezikut kreditor.**

**Gjatë simulimit ekstrem hipotetik për kalimin e 30% të ekspozimit kreditor ndaj subjekteve jofinanciare, nga ajo ekzistuese, në dy kategoritë e ardhshme me rrezik më të lartë, shkalla e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar ulet për 5,2 pikë përqindjeje në raport me nivelin fillestar, pra nga 18,1% në 12,9%, që është një rezultat minimalisht më i mirë krahasuar me një vit më parë, kur rënia ishte për 5,3 pikë përqindjeje në raport me nivelin fillestar.**



Grafiku nr. 32 Ulja e shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë simulimit për gradim në përkeqësimin e cilësisë së ekspozimit të rrezikun kreditor të bankave ndaj subjekteve jofinanciare nga ai ekzistues, në dy kategoritë e mëposhtme të rrezikut

në pikë përqindjeje




Burimi: Llogaritjet e Bankës Popullore, duke përdorur të dhënat e ofruara nga bankat.

Gjatë **simulimit të realizimit të rrezikut kreditor nga përqendrimi në portofolin kreditor**, përmes një kalimi të supozuar të dhjetë klientëve më të mëdhenj nga sektori jofinanciar i secilës bankë, veçmas, nga kategoria e rrezikut aktual (kryesisht "A") në kategorinë e rrezikut "B-jofunksional", raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e sistemit bankar është ulur për 3,6 p.p.; nga 18,1% fillestare në 14,5%, që është një rezultat më i mirë krahasuar me vitin e kaluar. Ulja e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në një skenar të këtillë për një bankë individuale do të ndryshonte nga 1,3 pikë përqindjeje në 6,2 pikë përqindjeje, ndërkohë që kjo shkallë nuk do të binte nën 8% për asnjë bankë.

Grafiku nr. 33 Ulja e shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e sistemit bankar kur realizohet rreziku i përqendrimit të ekspozimit ndaj subjekteve jofinanciare

në pikë përqindjeje




Burimi: Llogaritjet e Bankës Popullore, duke përdorur të dhënat e ofruara nga bankat.



Grafiku nr. 34 Kontributi i aktiviteteve individuale mbizotëruese të shoqërive jofinanciare dhe produkteve kreditore të amvisërive në uljen e shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë simulimit për gradim në përkeqësimin e cilësisë së ekspozimit ndaj rrezikut kreditor.

në pikë përqindjeje



Burimi: Llogaritjet e Bankës Popullore, duke përdorur të dhënat e ofruara nga bankat.

**Rezistenca e sistemit bankar shqyrtohet edhe duke kryer një simulim ekstrem të bazuar në një kombinim të tetë<sup>33</sup> goditjeve hipotetike të përkeqësimit të cilësisë së portofolit kreditor ndaj sektorit jofinanciar.** Goditjet u referohen segmenteve të ndryshme të ekspozimit, të cilat përcaktohen sipas disa karakteristikave që përcaktojnë shkallën e rrezikshmërisë së tij (mosfunksionaliteti, vonesa në përmbushjen e detyrimeve monetare, ristrukturimi, zgjatja, periudha mospagesës e miratuar dhe shlyerja e dakorduar e njëhershme). Gjithashtu, në rastin e disa goditjeve për cilësinë e portofolit kreditor, përcaktimi i forcës së

<sup>33</sup> Tetë goditjet hipotetike të ekspozimit të rrezikut ndaj subjekteve jofinanciare për secilën bankë janë si më poshtë: 1. Mosshlyerja e plotë e ekspozimit ekzistues të kredive me probleme; 2. një pjesë e kredive të rregullta, ku ka mbi 32 ditë vonesa në shlyerje, marrin statusin me probleme. Pjesa që merr statusin me probleme përcaktohet në lartësinë e mesatares dhjetëvjeçare të shkallës së kalimit të ekspozimit, nga kategoritë e rrezikut "B" dhe "C - rregullt" në kategoritë e rrezikut "C - me probleme", "Ç" dhe "D", në secilën bankë veç e veç; 3. totali i ekspozimit të rregullt të ristrukturuar, i cili aktualisht nuk ka vonesa në përmbushjen e detyrimeve në para, fiton statusin me probleme; 4. ristrukturime të reja të ekspozimit të rregullt kreditor që aktualisht nuk ka vonesa në përmbushjen e detyrimeve në para, të reduktuara për ekspozimin e kredive me shlyerje të njëhershme të kryegjësë me marrëveshje, që duhet të paguhet në vitin pasardhës. Vëllimi i ristrukturimeve të reja bazohet në mesataren dhjetëvjeçare të shkallës së kalimit të ekspozimit, nga kategoria e rrezikut "A", në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C - rregullt", në secilën bankë veç e veç; 5. një pjesë e kredive me periudhë mospagimi të miratuar që skadon në një periudhë nga një tremujor, deri në një vit, pas datës së raportimit merr statusin me probleme. Pjesa që merr statusin me probleme, përcaktohet në lartësinë e mesatares dhjetëvjeçare të shkallës së kalimit të ekspozimit, nga kategoritë e rrezikut "A", "B" dhe "C - rregullt", në kategoritë e rrezikut "C - me probleme", "Ç" dhe "D" në secilën bankë veç e veç; 6. një pjesë e ekspozimit të zgjeruar që aktualisht nuk ka vonesa në përmbushjen e detyrimeve në para, merr statusin me probleme dhe kjo pjesë përcaktohet në lartësinë e mesatares dhjetëvjeçare të shkallës së kalimit të ekspozimit, nga kategoritë e rrezikut "A", "B" dhe "C - rregullt", në kategoritë e rrezikut "C - me probleme", "Ç" dhe "D" në secilën bankë veç e veç; 7. Një pjesë e ekspozimit të rregullt, të paristrukturuar dhe të pazgjeruar kreditor, që aktualisht nuk ka vonesa në përmbushjen e detyrimeve në para dhe ku ka marrëveshje për shlyerje të njëhershme të kryegjësë dhe që duhet të paguhet në vitin pasardhës, merr statusin me probleme. Pjesa që merr statusin me probleme, përcaktohet në lartësinë e shumës së mesatares dhjetëvjeçare të shkallës së kalimit të masës së ekspozimit, nga kategoria e rrezikut "A", në kategoritë e rrezikut "C - me probleme", "Ç" dhe "D", në secilën bankë veç e veç dhe të mesatares dhjetëvjeçare të shkallës së kalimit të shumës së ekspozimit, nga kategoria e rrezikut "A", në kategoritë e rrezikut "B" dhe "C - rregullt", në secilën bankë veç e veç; dhe 8. Disa nga kreditë e rregullta, ku ka deri në 32 ditë vonesa në shlyerje, e rritin periudhën e vonesës me më shumë se 32 ditë. Pjesa që rrit periudhën e vonesës përcaktohet në lartësinë e mesatares dhjetëvjeçare të shkallës së kalimit të shumës së ekspozimit, nga kategoritë e rrezikut "A" në "B" dhe "C - rregullt", në secilën bankë veç e veç. Mbulimi i zhvlerësimit, pas secilës prej tetë goditjeve, është i njëjtë me atë të para goditjes.



goditjes së simuluar lidhet me dinamikën historike të shkallëve të tranzicionit të ekspozimit përkatës, pra me dhjetëvjeçarin e tyre mesatar

Në këtë simulim ekstrem, mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar nuk ulet nën minimumin e përcaktuar. Në fakt, pas këtij simulimi, shkalla e mjaftueshmërisë së kapitalit zvogëlohet me 4.9 pikë përqindjeje në nivelin 13%<sup>34</sup> (për 5,1 p.p., pra nga 17,6% në 12,4% në mënyrë përkatëse në fund të 2022). Goditjet do të çonin në përthithjen e 27,3% të shkallës fillestare të mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili është më i ulët krahasuar me fundin e një viti më parë (29,3% e nivelit fillestar të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit). Efektin më të madh në shkallën e mjaftueshmërisë së kapitalit e ka ristrukturimi i ri i supozuar i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor që bankat do të zbatonin në ekspozimin e rregullt ku aktualisht nuk ka vonesa në përmbushjen e detyrimeve monetare (kontributi prej 41,5% në uljen e mjaftueshmërisë së kapitalit), e ndjekur nga përkeqësimi i cilësisë së ekspozimit kreditor ku është dakorduar një shlyerje e njëhershme kryegjësë dhe që duhet të kthehet në vitin e ardhshëm (kontributi prej 19,2%) dhe mospagesa e plotë e ekspozimit ekzistues jofunksional (kontributi prej 14,8%)<sup>35</sup>.

Grafiku nr. 35 Shpërndarja e rënies së shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivel të sistemit bankar pas goditjeve të veçanta në përqindje



Burimi: Llogaritjet e Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

<sup>34</sup> Shkalla fillestare e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar është pa BZhRMV SHA Shkup, e cila është përjashtuar nga ky simulim.

<sup>35</sup> Cilësia e ekspozimit kreditor ku ka ristrukturime të reja brenda ekspozimit të rregullt, ku aktualisht nuk ka vonesa dhe cilësia e ekspozimit kreditor, ku është dakorduar një shlyerje e njëhershme e kryegjësë dhe që duhet të paguhet në vitin e ardhshëm, shënon përkeqësim të caktuar, ndërkohë që mospagesa totale e ekspozimit me probleme ekzistuese tregon një përmirësim minimal, kështu që kontributi i tyre në uljen e shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit, krahasuar me vitin 2022, u rrit për 4,1 p.p. dhe 0,9 p.p., përkatësisht u ul për 0,6 p.p.



### **Analiza e ekspozimit të sistemit bankar ndaj rreziqeve klimatike<sup>36</sup>**

Rreziqet financiare të klimës u referohen rreziqeve të mundshme që rrjedhin nga ndryshimet klimatike dhe mund të ndikojnë në sigurinë dhe stabilitetin e institucioneve financiare individuale dhe të kenë ndikime më të gjera në stabilitetin financiar të sistemit bankar.<sup>37</sup> Në kontekstin e sistemit bankar, rreziqet klimatike i referohen probabilitetit të humbjes në operacionet bankare si pasojë e ngjarjeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Rreziqet e këtilla mund të ndahen në dy grupe: 1) rreziqet fizike dhe 2) rreziqet e tranzicionit. Rreziqet fizike lindin nga kushtet e motit dhe fatkeqësitë natyrore, ndërsa rreziqet e tranzicionit lindin nga ndryshimet në politika, rregullore dhe teknologji, për shkak të kalimit në një ekonomi me emetime të ulëta të karbonit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e rritjes së ndryshimeve klimatike në analizën e rezistencës së sistemit financiar, kjo analizë synon të vlerësojë ekspozimin e sistemit bankar ndaj rreziqeve klimatike (rreziqet fizike dhe rreziqet e tranzicionit). Ekspozimi ndaj rreziqeve fizike vlerësohet në bazë të shtrirjes gjeografike të klientëve dhe të pasurive të paluajtshme që janë lënë peng për kreditë e miratuara nga bankat, si dhe ekspozimit ndaj rreziqeve të tranzicionit nëpërmjet ekspozimit kreditor të sistemit bankar ndaj klientëve nga aktivitete të ndjeshme ndaj klimës<sup>38</sup>.

**Ekspozimi kreditor ndaj personave fizikë në fund të vitit 2023 shënoi një rritje prej 6,4% me bazë vjetore.** Në të njëjtën kohë, nga aspekti i vendbanimit të personave fizikë, rritje e ekspozimit ndaj kredisë është vërejtur në të gjitha rajonet, me përjashtim të rajonit të Pollogut (ulje prej 5,4%), dhe shkalla më e lartë e rritjes vjetore është në rajonin verilindor dhe është 23,6%. Pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e ekspozimit kreditor e ka ekspozimi ndaj personave fizikë nga rajoni i Shkupit (47,7%), pasuar nga ekspozimet ndaj personave fizikë nga rajoni i Pellagonisë (10,1%) dhe rajoni jugperëndimor (9,0%).

Sa i përket vendndodhjes së pasurive të paluajtshme që merren si garanci për kreditë e personave fizikë, pjesëmarrjen më të madhe më 31.12.2023 e zënë kreditë e siguruara me pasuri të paluajtshme në rajonin e Shkupit (61,4%), pasuar nga kreditë e siguruara me pasuri të paluajtshme në rajonin jugperëndimor (9,3%). Dinamika e ndryshimeve të pjesëmarrjes në pesëvjeçarin e fundit tregon se nuk ka ndryshime të theksuara në strukturë, kështu që rritja më e theksuar e pjesëmarrjes në periudhën 2019-2023 është në rajonin e Shkupit me 0,7 pikë përqindjeje, ndërsa rënia më e dukshme në të njëjtën periudhë është në rajonin juglindor me 0,9 pikë përqindje.

<sup>36</sup> Termi "rreziqe klimatike" u referohet rreziqeve totale në shoqërinë dhe ekosistemin që lindin si pasojë e ndryshimeve klimatike, por në këtë analizë përdoret në kontekstin e sektorit financiar dhe ka të njëjtin kuptim me termin "rreziqe financiare klimatike".


<sup>37</sup> BIS (2020). *Climate-related financial risks: a survey on current initiatives*. ISBN 978-92-9259-375-9 (online).

<sup>38</sup> Aktivitetet e ndjeshme ndaj klimës janë aktivitetet që konsiderohen të rëndësishme në zbatimin e politikës klimatike dhe përcaktohen në bazë të klasifikimit të bërë në Battiston, S., Mandel, A., Monasterolo, I., Schütze, F., & Visentin, G. (2017). A Climate stress-test of the financial system. *Nature Climate Change*, 7(4): 283–288. <https://doi.org/doi:10.1038/nclimate325>.



## Grafiku nr. 36

Struktura e ekspozimit kreditor të bankave ndaj personave fizikë sipas rajoneve<sup>39</sup> ku personat fizikë janë rezidentë (majtas) dhe struktura e kredive të personave fizikë të siguruara me pasuri të paluajtshme sipas rajonit ku ndodhet pasuria e paluajtshme (djathtas)<sup>40</sup> në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore dhe të dhënat e ofruara nga bankat.

**Ekspozimi kreditor ndaj shoqërive jofinanciare në fund të vitit 2023 shënoi një rritje prej 3,6%.** Në të njëjtën kohë, rritja është kryesisht për shkak të rritjes së ekspozimeve ndaj shoqërive me seli në rajonin verilindor (8,1%) dhe atë të Pollogut (8,0%), kurse rënia më e dukshme është në ekspozimin ndaj shoqërive në rajonin e Vardarit (14,0%). Në strukturën e ekspozimit kreditor mbizotëron rajoni i Shkupit me 56,8%, i ndjekur nga rajoni i Pellagonisë me 7,7%.

Analiza e vendndodhjes së pasurive të paluajtshme të marra si garanci për kreditë e shoqërive jofinanciare tregon se pjesëmarrjen më të madhe prej 53,5% në strukturë më 31.12.2023 e kanë pasuritë e paluajtshme në rajonin e Shkupit, që paraqet një rritje prej 4,8 pikë përqindjeje krahasuar me 31.12.2022, e ndjekur nga pasuritë e paluajtshme në rajonin juglindor, me një pjesëmarrje prej 8,6%. Rritje të pjesëmarrjes në baza vjetore, përveç rajonit të Shkupit, ka edhe në rajonin e Pollogut, ndërsa rënie ka në të gjitha rajonet e tjera. Në pesëvjeçarin e fundit, struktura sipas rajoneve nuk ka pasur ndryshime të mëdha, por një rritje e lehtë u vërejt në rajonin e Shkupit dhe një rënie e lehtë në rajonin juglindor.


<sup>39</sup> Struktura e ekspozimit kreditor nuk përfshin ekspozimet ndaj rezidentëve të cilëve nuk u dihet adresa e vendbanimit dhe ndaj jorezidentëve, të cilët janë të parëndësishëm (0,4% ndaj rezidentëve të tjerë dhe 0,04% ndaj jorezidentëve).

<sup>40</sup> Shkalla e rrezikut sipas rajoneve përcaktohet në bazë të vlerës së referencës, e cila llogaritet si një mesatare e shkallëve të rrezikut për qytetet që ndodhen në to. Për çdo qytet, shkalla e rrezikut përfaqëson një mesatare të ponderuar të shkallëve individuale të rrezikut për këto katër lloje të fatkeqësive natyrore: 1) vërshimet e lumenjve, 2) përmbytjet urbane, 3) zjarret në pyje dhe 4) nxehtësia ekstreme. Vlerat e paracaktuara për shkallë të ndryshme rreziku janë 1 për rrezik shumë të ulët, 2 për rrezik të ulët, 3 për rrezik të mesëm dhe 4 për rrezik të lartë. Ponderët vërtetohen në bazë të pjesëmarrjes së frekuencës së ndodhjes së çdo fatkeqësie natyrore në numrin total të fatkeqësive në periudhën 2004-2023. Nëse vlera e referencës për rajonin është nga 1,00 në 1,74, atëherë rreziku është shumë i ulët; nëse është nga 1,75 në 2,49, atëherë rreziku është i ulët; nëse është nga 2,50 në 3,24, atëherë rreziku është mesatar; dhe nëse është 3,25 deri në 4,00, atëherë rreziku është i lartë.



## Grafiku nr. 37

Struktura e ekspozimit kreditor të bankave ndaj shoqërive jofinanciare sipas rajoneve<sup>41</sup> ku është selia e shoqërisë (majtas) dhe struktura e kredive të shoqërive jofinanciare të siguruar me pasuri të paluajtshme sipas rajonit ku ndodhet pasuria e paluajtshme (djathtas)<sup>40</sup> në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore dhe të dhënat e ofruara nga bankat.

**Në vitin 2023, ekspozimi kreditor ndaj shoqërive jofinanciare nga aktivitetet e ndjeshme ndaj klimës shënoi një rritje prej 6,8%, ndërsa ekspozimi ndaj aktiviteteve të tjera u ul për 0,6%.** Lëvizjet e këtilla kontribuan në rritjen e pjesëmarrjes së ekspozimit ndaj aktiviteteve të ndjeshme ndaj klimës në totalin e ekspozimit kreditor në 56,6% më 31.12.2023<sup>42</sup>, që thekson rëndësinë e këtyre aktiviteteve në menaxhimin e rrezikut kreditor në banka. Në kuadër të aktiviteteve klimatike, rritja më e dukshme vërehet në ekspozimin ndaj klientëve në aktivitetet e shërbimeve komunale (24,9%), ndërsa rënia më e madhe është te konsumatorët në aktivitetet prodhuese dhe shërbyese që lidhen me lëndët djegëse të ngurta dhe në aktivitetet e përqendruara energjetike (me nga 4,7%). Ulja e pjesëmarrjes së aktiviteteve të përqendruara energjetike dhe të lëndëve djegëse të ngurta në periudhën 2019-2023 është veçanërisht e rëndësishme për kalimin në prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë, që janë synime të rëndësishme në krijimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të gjelbër, si dhe në luftën për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. Nga aktivitetet e ndjeshme ndaj klimës, ekspozimi ndaj klientëve në ndërtimtari shënon pjesëmarrjen më të lartë në totalin e ekspozimit kreditor (19,4%) dhe ka prirje rritjeje, pra në periudhën 2019-2023 u rrit për 3,4 pikë përqindje. Megjithatë, rritjen më të lartë në pesëvjeçarin e fundit për 3,5 pikë përqindje e shënuan shërbimet komunale (kryesisht te klientët nga biznesi i prodhimit të energjisë elektrike).

<sup>41</sup> Struktura e ekspozimit kreditor nuk përfshin ekspozimet ndaj shoqërive jofinanciare rezidente të cilave nuk u dihet adresa e vendbanimit dhe ndaj jorezidentëve, të cilat janë shumë të ulëta (0,3% ndaj rezidentëve të tjerë dhe 1,8% ndaj jorezidentëve).


<sup>42</sup> Për krahasim, pjesëmarrja e ekspozimit kreditor ndaj aktiviteteve të ndjeshme ndaj klimës ishte 47,4% më 31.12.2019 dhe 54,8% më 31.12.2022.




Grafiku nr. 38

Shkalla e ndryshimit të ekspozimit kreditor të bankave ndaj aktiviteteve të ndjeshme ndaj klimës dhe të tjera (më pak të ndjeshme) dhe struktura e ekspozimit kreditor sipas aktivitetit (djathtas)

në përqindje



në përqindje




Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore.


Grafiku nr. 39

Shkalla e pjesëmarrjes së ekspozimit jofunksional në totalin e ekspozimit kreditor të bankave ndaj aktiviteteve të ndjeshme ndaj klimës dhe të tjera (më pak të ndjeshme) (majtas) dhe struktura e ekspozimit jofunksional sipas aktiviteteve (djathtas)

në përqindje



në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore.

**Ekspozimi jofunksional i bankave ndaj aktiviteteve të ndjeshme ndaj klimës në fund të vitit 2023 përbën 3,0% të totalit të ekspozimit kreditor, që është minimalisht më i lartë se pjesëmarrja e ekspozimit jofunksional ndaj të tjerëve (aktivitete më pak të ndjeshme ndaj klimës) prej 2,9%.** Sipas aktiviteteve individuale të ndjeshme ndaj klimës, aktivitetet e përqendruara energjetike (6,5%) kanë shkallën më të lartë të ekspozimit jofunksional, të ndjekura nga aktivitetet e transportit (4,1%). Më 31.12.2023, ekspozimi jofunksional ndaj aktiviteteve të ndjeshme ndaj klimës ka pjesëmarrjen më të madhe prej 57,7% në strukturën e totalit të ekspozimit jofunksional, që paraqet një rritje prej 9,9 pikë përqindjeje krahasuar me 31.12.2022 (duhet theksuar se këto pjesëmarrje në periudhën 2019-2023 karakterizohen me ndryshueshmëri më të lartë se pjesëmarrjet në strukturën e totalit të ekspozimit kreditor). Në mungesë të të dhënave më



cilësore, analizat e rrezikut të ndryshimeve klimatike kryhen duke përdorur të dhënat e disponueshme nga raportet mbikëqyrëse, prandaj nuk është e mundur të përcaktohet saktësisht ndikimi i rreziqeve klimatike në ndryshimet në ekspozimet jofunkionale në aktivitetet e ndjeshme ndaj klimës, domethënë nëse dhe në çfarë mase këto rreziqe ndikuan në shumën e kredive me probleme.




## 2. Rreziku i likuiditetit

### 2.1. Treguesit e likuiditetit

Në vitin 2023, rritja e mjeteve likuide të sistemit bankar kontribuoi në përmirësimin e treguesve të likuiditetit, lartësia i të cilit është në kornizat e niveleve të kënaqshme të zakonshme dhe mbi mesataren e tyre dhjetëvjeçare. Kështu, mjetet likuide marrin pjesë në totalin e aktives së bankave me 31,8% dhe mundësojnë mbulimin solid të detyrimeve dhe depozitave afatshkurtra nga amvisëritë me mjete likuide (nga 52.3%, përkatësisht 65,3%<sup>43</sup>).


Grafiku nr. 40 Treguesit e likuiditetit të sistemit bankar në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Gjatë llogaritjes së treguesve të likuiditetit në nivel të sistemit bankar, mjetet dhe detyrimet ndërbankare rezidente nuk merren parasysh.

Grafiku nr. 41 Aktivja likuide / aktivja totale (majtas), aktivja likuide / detyrimet afatshkurtra (në mes) dhe aktivja likuide / depozitat e amvisërive (djathtas) në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Shkalla e mbulimit të likuiditetit të sistemit bankar (ang. Liquidity Coverage Ratio) është 263,5% dhe është dukshëm më e lartë se minimumi rregullator (100%<sup>44</sup>), që konfirmon vëllimin e kënaqshëm të likuiditetit në dispozicion të sistemit bankar maqedonas. Sipas bankave individuale, shkallëz e mbulimit të likuiditetit ndryshojnë nga 150,8% në 1132,0% (me një mesatare prej 288,4%), që tregon gjithashtu kufijtë



e pranueshëm të rrezikut të likuiditetit ndaj të cilëve janë të ekspozuara bankat dhe menaxhimin e qëndrueshëm të likuiditetit nga ana e tyre.

Grafiku nr. 42 Shkalla e mbulimit të likuiditetit më 31.12.2023  
në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Sipas karakteristikave valutore të mjeteve likuide dhe detyrimeve, gjatë vitit 2023 ka përmirësim të treguesve edhe për denarin<sup>45</sup>, edhe për likuiditetin valutor.** Megjithatë, treguesit e likuiditetit në denarë tregojnë përmirësim më të madh, me rritje vjetore më të madhe në denarë (për 17,3%) sesa në mjetet likuide në valutë (për 11,5%). Po ashtu, treguesit e likuiditetit në denarë vazhdojnë të jenë në nivelin më të lartë, krahasuar me treguesit e likuiditetit valutor, që vjen si pasojë e pjesëmarrjes më të lartë strukturore të mjeteve likuide në denarë në gjithsej mjetet likuide të bankave.


<sup>43</sup> Sipas bankave individuale, më 31.12.2023, pjesëmarrja e mjeteve likuide në totalin e mjeteve është ndërmjet 22,5% dhe 50.1%, me një mesatare prej 31,1% (dhjetor 2022: midis 22,3% dhe 49,2%). Mbulimi i detyrimeve afatshkurtra me mjete likuide është midis 37,3% dhe 80,4%, me një mesatare prej 57,2% (dhjetor 2022: ndërmjet 34,6% dhe 64,2%), ndërkaq mbulimi i depozitave nga amvisëritë me mjete likuide ndërmjet 39,8% dhe 126%, me një mesatare prej 74,8% (dhjetor 2022: ndërmjet 35,5% dhe 105,0%). Nga kjo analizë është përjashtuar "Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut" ShA Shkup.

<sup>44</sup> Përveç në bazë të mbledhjes, bankat janë të detyruara të vendosin dhe monitorojnë një shkallë mbulimi të likuiditetit sipas çdo valute të rëndësishme për bankën (çdo valutë, pjesëmarrja e së cilës në totalin e detyrimeve të bilancit të bankës është të paktën 5%). Në të njëjtën kohë, nuk përcaktohet asnjë nivel minimal për shkallët e mbulimit të likuiditetit sipas valutës. Më 31 dhjetor 2023, normat e mbulimit të likuiditetit për dy monedhat kryesore, euro dhe denarë, janë përkatësisht 104.4% dhe 302.1%.

<sup>45</sup> Kërkesat dhe detyrimet me klauzolë valutore konsiderohen si denarë, sepse rrjedha e parasë së tyre është në denarë.



Grafiku nr. 43 Treguesit e likuiditetit të sistemit bankar sipas valutës - denarë (majtas) dhe valuta të huaja (djathtas)  
në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

## 2.2. Dinamika e përbërjes së mjeteve likuide

**Në fund të vitit 2023, mjetet likuide<sup>46</sup> në nivel të sistemit bankar ishin 231.198 milionë denarë.** Gjatë rritjes së mëtejshme dhe në të njëjtën kohë të përshpejtuar vjetore të depozitave (9,2% më 2023, kundrejt 5,4% në 2022), **mjetet likuide të sistemit bankar shënuan rritje të ndjeshme prej 15,3%, përkatësisht për 30.638 milionë denarë.** E

Grafiku nr. 44 Mjetet likuide, struktura (majtas) dhe ndryshimi (djathtas)  
në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

analizuar sipas instrumenteve financiare individuale që përbëjnë mjetet likuide, rritja më e theksuar është në plasmanet e bankave në depozitat shtatëditore të disponueshme në Bankën Popullore (që u rritën për gati shtatë herë, përkatësisht për 31.580 milionë denarë), kundrejt rënies së plasmaneve të bankave në depozita njëditore në Bankën Popullore. (për 18.990 milionë denarë ose për 44,1%<sup>47</sup>). Rritje të ndjeshme shënojnë edhe vendosjet e bankave në letrat me vlerë të qeverisë (vendosjet në bono thesari për 3.751 milionë denarë, ose për 22,9%, vendosjet në obligacionet e qeverisë për 3.677 milionë denarë, ose për 6,7% dhe vendosjet në letrat me vlerë të qeverisë së huaj për 3.772 milionë denarë, ose për 116,7%). Vendosjet e bankave në bono thesari janë rritur me 482 milionë denarë, ose për 5,1%<sup>48</sup>, ndërsa mjetet e llogarisë në denarë në Bankën Popullore janë zvogëluar për 168 milionë denarë, ose për %. Gjithashtu, rënie vihet re në



aktivet e bankave në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra të vendosura në bankat e huaja<sup>49</sup>. Në të kundërt, mjetet e llogarisë së pagesave valutore në Bankën Popullore shënuan rritje prej 6.560 milionë denarë, ose për 117,1%, e cila lidhet më së shumti me ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyruar<sup>50</sup>.

### **2.3. Struktura e maturimit të hyrjeve dhe të daljeve të dakorduara nga mjetet dhe detyrimet e bankave**

**Me gjendjen e datës 31.12.2023, në strukturën e maturimit të hyrjeve dhe të daljeve të bankave, flukset hyrëse të dakorduara të bankave shtrihen në periudhën kohore mbi një vit dhe daljet e dakorduara të bankave të shpërndara në periudhën kohore deri në shtatë.** Në të njëjtën kohë, diferenca (hendeku) më e madhe midis hyrjeve dhe daljeve të bankave vihet re pikërisht në periudhat kohore deri në shtatë ditë (hendek negativ) dhe mbi një vit (hendek pozitiv), që rezulton nga përfshirja e detyrimeve në shikim dhe pa maturim fiks në segmentin e maturimit deri në shtatë ditë dhe për shkak të pretendimeve të bazuara në kreditë e përfshira në segmentet e maturimit mbi një vit (kreditë afatgjata në nivel të sistemit bankar përbëjnë rreth 80% të totalit të kredive për subjektet jofinanciare). Sa i përket aktiveve të sistemit bankar, hendeku agregat deri në 7 ditë dhe hendeku agregat deri në 1 vit janë 36,7% dhe 25,1%.

<sup>46</sup> Mjetet likuide përfshijnë: 1) mjetet monetare dhe kërkesat nga Banka Popullore, të cilat përfshijnë mjetet monetare efektive, mjetet monetare të gatshme në llogaritë bankare në Bankën Popullore, depozitat në dispozicion në Bankën Popullore dhe bonot e thesarit; 2) depozitat afatshkurtra në bankat e huaja, duke përfshirë mjetet e bankave në llogaritë e tyre korrespondente jashtë vendit dhe 3) vlerën kontabël të plasmaneve në letrat me vlerë të emetuara nga qeveritë qendrore, përkatësisht letrat me vlerë të shtetit të emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe të emetuara nga vende të huaja. Për qëllime të analizës së rrezikut të likuiditetit, mjetet dhe detyrimet në denarë me klauzolë valutore konsiderohen në denarë.

<sup>47</sup> Gjatë vitit 2023, Banka Popullore vazhdoi shtrëngimin e politikës monetare, që filloi në fund të vitit 2021 me menaxhim aktiv të likuiditetit përmes ndërhyrjeve në tregun valutor dhe nga prilli 2022, me rritjen e normave të interesit. Konkretisht, normat e interesit për depozitat njëditore dhe shtatëditore u rritën në disa raste gjatë vitit 2023, me gjithsej 1,55 pikë përqindjeje, përkatësisht në nivelin 4,20% dhe 4,25%. Në tremujorin e parë të vitit 2024, Banka Popullore vlerësoi se përcaktimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm me kushtet në ekonomi dhe nuk bëri ndryshime të mëtejshme në përcaktimin e saj.


<sup>48</sup> Gjatë vitit 2023, norma e interesit për bonot e thesarit u rrit gjashtë herë me gjithsej 1,55 pikë përqindjeje, me të cilën arriti në 6,3% (sipas kushteve në ekonomi, norma bazë e interesit u mbajt në nivelin 6,3% dhe në tremujorin e parë të 2024). Shuma e ofruar e bonove të thesarit është e pandryshuar, përkatësisht arrin në 10.000 milionë denarë.

<sup>49</sup> Zvogëlimi i mjeteve të bankave në llogaritë në bankat e huaja për 6,616 milionë denarë ose për 41,0%, ndërsa depozitat afatshkurtra të bankave të vendosura në bankat e huaja për 5,492 milionë denarë, ose për 32,6%.

<sup>50</sup> Në vitin 2023, raporti i rezervës së detyruar të detyrimeve në valutë u rrit nga 19% në 21%, dhe pjesëmarrja e rezervës së detyruar në euro që plotësohet në euro u rrit nga 75% në 81%. Në të njëjtën kohë, norma për obligimet në denarë me klauzolë valutore është rritur nga 50% në 100%.




Grafiku nr. 45 Struktura afatshkurtër e hyrjeve dhe daljeve bazuar në aktivet dhe detyrimet e bilancit (majtas) dhe hendekun agregat midis hyrjeve dhe daljeve të kontraktuara, duke përfshirë shumën totale të aktiveve të pangarkuara (djathtas)  
në milionë denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 46 Stabiliteti i pritur i depozitave, sipas periudhës së mbetur deri në maturim, më 31.12.2023

në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Bankat presin ruajtjen e stabilitetit të depozitave si burimin kryesor të financimit të aktiviteteve të tyre.** Në pajtueshmëri me sjelljen e depozituesve, bankat vlerësojnë se pjesa më e madhe e daljeve të parave të dakorduara (ose 87,1%) në bazë të depozitave nuk do të realizohen nga depozituesit në 12 muajt e ardhshëm.



## 2.4. Simulimet e stresit për goditjet e likuiditetit

**Në datën 31.12.2023, rezultatet e simulimeve të stresit të kryera për goditjet e likuiditetit tregojnë për kapacitet solid të sistemit bankar, i cili ka aktive të mjaftueshme likuide për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate daljeve të simuluar të mjeteve monetare.** Rezistenca e sistemit bankar maqedonas ndaj goditjeve të likuiditetit konfirmohet përmes rezultateve të të gjitha simulimeve individuale të goditjeve të likuiditetit, dhe përdorimi i plotë (ose 104.2%, më 31.12.2023) i aktiveve likuide do të ndodhte vetëm në simulimin jashtëzakonisht ekstrem të goditjes së likuiditetit, i cili përfshin daljet e kombinuara<sup>51</sup> të fondeve nga bankat për disa arsye. Duke pasur parasysh skajshmërinë e supozimit, për qëllimet e këtij simulimi, mbulimi i zakonshëm i aktiveve likuide është zgjeruar për të përfshirë instrumente të tjera financiare<sup>52</sup> në pronësi të bankave, të cilat vlerësohen të arkëtohen shpejt dhe lehtë ose të konvertohen në para nga bankat. Dhe në rast të tillë, kur simulohen goditjet e supozuara të kombinuara, aktivet likuide të sistemit bankar kanë kapacitetin për të mbuluar të gjitha daljet e supozuara.

**Me rastin e zbatimit të simulimeve individuale të goditjeve të likuiditetit, niveli i lartë i mjeteve likuide në dispozicion të bankave maqedonase mundëson shlyerjen e të gjitha daljeve të supozuara, individuale, ekstreme të likuiditetit.** Rënia më e madhe e aktiveve likuide ndodh gjatë simulimit të daljes së depozitave të dhjetë depozituesve më të mëdhenj, dhe kuptimi i këtij simulimi për bankat individuale është i ndryshëm, duke pasur parasysh dallimet në shkallën e përqendrimit të depozitave. Përkundrazi, në simulimin e realizimit të rrezikut të reputacionit dhe humbjes së besimit të popullatës tek bankat e përfaqësuar nga dalja e 20% e depozitave të amvisërive, ka ngjashmëri më të madhe në rezultatet për bankat individuale, që konfirmon rëndësinë e besimit të publikut në sistemin bankar. Në konvertimin e supozuar të disa detyrimeve jashtë bilancit të bankave në kërkesat e bilancit<sup>53</sup>, bankat do të shpenzonin rreth 15% të aktiveve të tyre likuide. Pjesëmarrja e vogël e detyrimeve ndaj jorezidentëve, si dhe ndaj personave të regjistruar në strukturën e totalit të burimeve të financimit të bankave, shkakton ndikim modest të goditjeve që lidhen me to në rezultatin e përgjithshëm të këtij simulimi.

<sup>51</sup> Simulimi supozon dalje të: depozitave të dhjetë depozituesve më të mëdhenj, 20% të depozitave të amvisërive, detyrimeve ndaj subjekteve mëmë (detyrimet e bazuara në instrumente të varur dhe instrumente kapitale hibride janë përjashtuar nga simulimi sepse, në pajtim me rregulloren për llogaritjen e mjaftueshmëria e kapitalit, rregullohet pagesa e tyre), 50% nga detyrimet ndaj jorezidentëve (me përjashtim të detyrimeve ndaj personave amë jorezidentë të bankave, të cilat tashmë mbulohen nga një nga simulimet e mëparshme) dhe konvertimi i disa detyrimeve jashtë bilancit të bankave (kreditë e pambuluara, të parevokueshme linjat e kreditit dhe limitet e papërdorura bazuar në kartat e kreditit dhe mbiterheqjet e miratuara në llogaritë e transaksionit) në të arkëtueshmet e bilancit. Në simulimet për goditjet e likuiditetit, është përjashtuar "Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut" ShA Shkup.

<sup>52</sup> Përveç instrumenteve financiare që përbëjnë aktivet likuide, shtohen edhe instrumentet e mëposhtme financiare: mjetet në fondin e garancisë rezervë në KIBS, depozitat afatgjata në bankat e huaja, instrumentet e tregut të parasë të emetuara nga emetuesit e huaj joshitetorë, kreditë me maturim të mbetur kontraktual deri në 30 ditë, si dhe efekti i reduktimit të rezervë e detyrueshme për detyrimet valutore të bankave, e cila është lënë mënjanë në valutë për shkak të daljeve të simuluar të depozitave në valutë të amvisërive.


<sup>53</sup> Dalje fondesh supozohet si rezultat i konvertimit të disa detyrimeve jashtë bilancit të bankave (letër kreditë e pambuluara, linja krediti të parevokueshme dhe limite të papërdorura bazuar në kartela krediti dhe mbiterheqje të miratuara në llogaritë e transaksionit) në kërkesat e bilancit.



## Raport i rreziqeve në sistemin bankar për vitin 2023

Grafiku nr. 47 Kontributi i goditjeve individuale në reduktimin e aktiveve likuide në simulimin për goditje të kombinuar likuiditetit


si përqindje e reduktimit të aktiveve likuide



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 48 Rënia e aktiveve likuide pas simulimit për goditjet e kombinuara të likuiditetit (sipas të gjitha goditjeve)

në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.




### 3. Rreziku valutor

**Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sistemit bankar ndaj rrezikut valutor në fund të vitit 2023 është rritur, i cili reflektohet nga rritja e hendekut midis aktiveve dhe detyrimeve me komponent valutor dhe pozicionit të hapur valutor në raport me mjetet vetanake. Zgjerimi i hendekut është kryesisht rezultat i rritjes më të madhe të mjeteve me komponentë euro, në të cilën kontributin më të madh e kanë pasur mjetet e llogarive valutore në Bankën Popullore (llogaria e pagesave dhe rezerva e detyrueshme)<sup>54</sup>, si dhe kreditimi në euro dhe denarë me klauzolë euro. Pozicioni agregat valutor i të gjitha bankave është nën kufirin rregullator prej 30% në raport me mjetet vetanake, dhe të gjitha bankat kanë pozicion të gjatë valutor.**

**Ekspozimi indirekt i sistemit bankar është ulur, gjë që është reflektuar në uljen e pjesëmarrjes së kredive me komponent valutor në totalin e portofolit të kredisë së bankave. Në të njëjtën kohë, kjo ulje është ekskluzivisht rezultat i rënies së pjesëmarrjes së kredisë për kompanitë jofinanciare, ndërkohë që pjesëmarrja e kredisë për amvisëritë vijon të rritet. Zbatimi i strategjisë së kursit të qëndrueshëm këmbimi është i rëndësishëm për zbutjen e rrezikut valutor ndaj të cilit janë të ekspozuar klientët e bankave, e si rrjedhim edhe të rrezikut indirekt valutor të bankave.**

Grafiku nr. 49

Ndryshimi vjetor në totalin e aktiveve, aktiveve me komponentë valutore dhe detyrimeve me përbërës valutor, në shuma (majtas) dhe në përqindje (djathtas)\*



Burimi: Banka Popullore, gjegjësisht raporti për pozicionin e hapur valutor, bazuar në të dhënat e ofruara nga bankat.  
 \* Mjetet janë mbi bazë neto, të reduktuara me korigjimin e vlerës për kërkesat që klasifikohen në kategoritë e rrezikut "B", "G" dhe "D" në pajtim me rregulloren për administrimin e rrezikut valutor. BZhRM-ja nuk është përfshirë në analizë sepse, në pajtim me rregulloret ligjore, rregulloret për pozicionin e hapur valutor nuk zbatohen për BZhRM-në.

<sup>54</sup> Në vitin 2023, raporti i rezervës së detyruar të detyrimeve në valutë u rrit nga 19% në 21%, dhe pjesëmarrja e rezervës së detyruar në euro që plotësohet në euro u rrit nga 75% në 81%. Në të njëjtën kohë, norma për obligimet në denarë me klauzolë valutore është rritur nga 50% në 100%. Këto ndryshime në instrumentin e rezervës së detyrueshme kanë për qëllim nxitjen e kursimit në denarë.




**Hendeku pozitiv ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve me komponentë valutore në fund të vitit 2023 u zgjerua ndjeshëm dhe arriti në 11.469 milionë denarë,** që është rritje për më shumë se dyfish në krahasim me 31.12.2022 kur ishte 5.614 milionë denarë. Zgjerimi i hendekut është rezultat i rritjes më të madhe të mjeteve (për 18.254 milionë denarë, ose për 6,2%)<sup>55</sup> sesa rritja e detyrimeve (për 12.399 milionë denarë, ose për 4,3%)<sup>56</sup>. Në të njëjtën kohë, hendeku negativ ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve në valutë u ngushtua, ndërsa hendeku pozitiv ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve në denarë me klauzolë valutore u zgjerua. Lëvizje të tilla tregojnë rritje të ekspozimit të drejtpërdrejtë të bankave ndaj rrezikut valutor. Gjithashtu, raporti i pozicionit të hapur valutor<sup>57</sup> dhe mjetet vetanake, që janë 10,7%, tregojnë rritje në krahasim me një vit më parë dhe tejkalojnë mesataren e saj dhjetëvjeçare, por janë dukshëm nën kufirin e përcaktuar prej 30%.


#### Grafiku nr. 50

Struktura e hendekut midis aktiveve dhe detyrimeve me komponentë valutore (majtas) dhe pjesa e hendekut midis aktiveve dhe pasiveve me komponent valutore në mjetet vetanake (djathtas)

në milionë denarë



në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Rritja e aktiveve dhe e detyrimeve me komponentë valutore është ngadalësuar ndjeshëm krahasuar me një vit më parë dhe është më e ulët se rritja e totalit të aktiveve, e cila është përshpejtuar, gjë që është tregues i reduktimit të euroizimit të balanceve të bankave. Si rezultat i sa më sipër, pjesëmarrja e aktiveve me përbërës valutore u zvogëlua për 1,1 pikë përqindjeje dhe e detyrimeve me përbërës valutore me 1,9 pikë përqindje.

<sup>55</sup> Rritja e mjeteve me komponentë valutore është kryesisht pasojë e rritjes së mjeteve në llogaritë devizore në Bankën Popullore (llogaria e pagesës dhe rezerva e detyrueshme) për 14.714 milionë denarë, kreditë me komponentë valutore për 3.942 milionë denarë (nga të cilat denarë kreditë me klauzolë devizore për 3.335 milionë denarë dhe kreditë në valutë për 607 milionë denarë), ndërsa rritje shënuan edhe plasmanet në instrumente borxhi të lëshuara nga qeveritë e huaja qendrore për 1.476 milionë denarë.

<sup>56</sup> Rritja e detyrimeve me komponentë valutore në masë të madhe vjen si pasojë e rritjes së depozitave në valutë të personave fizikë për 6.267 milionë denarë, e mjeteve në llogaritë e pagesave dhe detyrimeve tjera afatshkurtra për 4.078 milionë denarë, si dhe e detyrimeve nga kreditë në valutë të huaj të bankave për 2.336 milionë denarë.


<sup>57</sup> Në përlogaritjen e pozicionit të hapur valutore, përveç hendekut ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve të bilancit me komponent valutore, përfshihet edhe hendeku ndërmjet aktiveve jashtëbilancore dhe detyrimeve me komponent valutore.



Grafiku nr. 51

Mesatarja, minimumi dhe maksimumi dhjetëvjeçar për treguesin ODP/mjetet vetanake (majtas) dhe pjesëmarrja e aktiveve dhe detyrimeve me komponentë valutore\* në totalin e aktiveve të bankave (djathtas)

në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* Në kuadër të aktiveve, kërkesat merren në bazë neto, respektivisht zvogëlohen për shumën e korrigjimit të vlerës së kryer. BZhRM-ja është përjashtuar nga analiza.


Grafiku nr. 52

Struktura e hendekut midis aktiveve dhe detyrimeve me një komponent të monedhës sipas valutës (majtas) dhe lëvizja e kursit të këmbimit të denarit kundrejt dollarit amerikan, frangut zvicerane, funtit britanik dhe dollarit australian (djathtas)

në milionë denarë



në denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Sipas valutave individuale, zgjerimi i hendekut pozitiv vjen kryesisht si pasojë e pozicionit të gjatë në euro** (duke përfshirë pozicionet me klauzolë valutore), dhe mbështetet gjithashtu nga ngushtimi ndjeshëm i hendekut negativ midis pozicioneve në dollarë amerikanë dhe hendekut në franga zvicerane, i cili kaloi nga negativ në pozitiv. Më 31.12.2023, hendeku



ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve me komponentë euro ishte 12.695 milionë denarë, i cili është zgjeruar për 2.923 milionë denarë, ose 29,9%, krahasuar me fundin e vitit paraprak. Ky zgjerim është rezultat i rritjes më të lartë të aktiveve sesa rritja e detyrimeve në këtë valutë<sup>58</sup>. Pozicioni valutor me komponentë në dollarë është ende i shkurtër, por tregon ngushtim të theksuar (për 2.009 milionë denarë, ose 61,8%), që rezultojnë nga rritja dukshëm më e lartë e aktiveve në krahasim me detyrimet<sup>59</sup>. Vlera e dollarit amerikan është stabilizuar gjatë vitit 2023, por është ende mbi mesataren afatgjatë. Pozicioni i këmbimit valutor në franga zvicerane është i gjatë në kushtet e rritjes së ndjeshme të aktiveve në këtë valutë, ndërsa pozicionet në funt britanik dhe dollarë australian janë të shkurtra<sup>60</sup>. Me të gjitha monedhat e tjera, pozicioni i shkurtër i këmbimit valutor shfaqet kolektivisht.

Tabela nr. 3

Struktura valutore e aktiveve dhe detyrimeve me komponentë valutore në përqindje

| Valutë                    | 31.12.2022   |              | 31.12.2023   |              |
|---------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
|                           | Aktiva       | Pasivi       | Aktiva       | Pasivi       |
| <b>Euro</b>               | 91.2         | 89.6         | 90.5         | 89.8         |
| <b>Dollari amerikan</b>   | 5.9          | 7.1          | 6.5          | 7.1          |
| <b>Franga zvicerane</b>   | 1.2          | 1.3          | 1.5          | 1.4          |
| <b>Dollari australian</b> | 0.5          | 0.6          | 0.4          | 0.5          |
| <b>Paundi britanik</b>    | 0.5          | 0.6          | 0.5          | 0.5          |
| <b>Të tjera</b>           | 0.7          | 0.8          | 0.6          | 0.7          |
| <b>Gjithsej</b>           | <b>100.0</b> | <b>100.0</b> | <b>100.0</b> | <b>100.0</b> |

Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Euro ka pjesëmarrjen më të madhe në strukturën valutore të aktiveve dhe detyrimeve në fund të vitit 2023.** Kjo reflektohet nga fakti se deri 99,9% e kredive me komponent valutor dhe 87,8% e depozitave me komponent valutor janë në këtë valutë. Prandaj, zbatimi i politikës së kursit të qëndrueshëm nominal të këmbimit të denarit në raport me euron vazhdon të jetë faktor i rëndësishëm në zbutjen e rrezikut valutor të bankave.

**Ekspozimi indirekt i sistemit bankar ndaj rrezikut valutor më 31.12.2023 është ulur, e cila u reflektua nga pjesëmarrja më e ulët e kredive me komponent valutor në portofolet e kredisë së bankave.** Në fund të vitit 2023, pjesëmarrja e kredive me komponentë valutore në totalin e kredive shënoi vlerën 42,2%, që është më pak me 1,0 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2022. Ky ulje është shkaktuar nga rënia e pjesëmarrjes së këtyre

Simulimi i normave të tranzicionit që mund të përballojë kapitali i bankave ka treguar rezultate më të mira krahasuar me vitet e mëparshme, domethënë, tregon se mjaftueshmëria e kapitalit zvogëlohet në 8% kur 18,3% e ekspozimit të rregullt të kredisë kalon në ekspozimin jofunksional. Ky tranzicion korrespondon me rritje të ekspozimit kreditor me probleme ndaj subjekteve jofinanciare me 577,3%. Për vitin 2022, këto norma ishin 17,4% dhe 526,6%. Megjithatë, këto janë simulime mjaft ekstreme dhe më pak të mundshme, veçanërisht në afat të shkurtër, duke qenë se në vitin 2023, ekspozimi i kredisë me probleme ndaj subjekteve jofinanciare shënon rritje vjetore prej 0,9%. Nga ana tjetër, në vitin 2023, vetëm 1% e ekspozimit të rregullt të kredisë ndaj sektorit jofinanciar mori statusin me probleme. Megjithatë, duke marrë parasysh mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm, ende të pasigurt, aftësia e pagesës e sistemit bankar, e cila është në nivel të kënaqshëm, zbut ndjeshëm efektet e mundshme negative të realizimit eventual të rreziqeve të çdo natyre.




#### **IV. Ndryshimet më të rëndësishme të bilancit dhe profitabiliteti i sistemit bankar**



## 1. Aktivitetet e bankave

**Bilanci i sistemit bankar shënoi rritje të përsheptuar në vitin 2023. Nga ana e burimeve të mjeteve, kontributin më të madh në rritjen vjetore e kanë depozitat nga personat jofinanciar, kapitali dhe rezervat dhe fitimet e realizuara në vitin 2023. Depozitat e amvisërive patën kontribut pak më të madh në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, ndonëse rritja e depozitave nga ndërmarrjet u përsheptua më shumë. Nga aspekti i karakteristikave valutore të depozitave, rritja vjetore e depozitave në denarë është disa herë më e lartë në krahasim me rritjen e depozitave në valutë. Me rënie të mëtejshme të depozitave afatshkurtra, depozitat afatgjata shënuan rritje vjetore në përqindje të lartë dhe krahasuar me depozitat pa afat, kontribuan pak më shumë në rritjen vjetore të gjithsej depozitave.**

Grafiku nr. 70 Struktura e aktiveve (lart majtas) dhe e detyrimeve (lart djathtas) dhe struktura e ndryshimeve tremujore të aktiveve (poshtë majtas) dhe detyrimeve (poshtë djathtas) të sistemit bankar në përqindje (lart) dhe në milionë denarë (poshtë)



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: \* Paratë e gatshme, llogaritë dhe depozitat në BPRMV dhe bankat tjera përfshijnë mjetet në fondin e garancisë rezervë të KIBS-it, si dhe rezervën e detyrueshme në valutë;


\*\* Instrumentet e tjera jodepozituese të emetuara përfshijnë instrumente kapitali të emetuar të varur dhe hibride.



**Në aktivet e sistemit bankar, mjetet likuide shënuan rritje më të ndjeshme, si dhe rritje më të madhe shënuan edhe kreditë, por dukshëm më ngadalë krahasuar me një vit më parë. Ngadalësimi i aktivitetit kreditor ka qenë më pak i theksuar te kredia për amvisëritë, të cilat kontribuan më së shumti në rritjen vjetore të totalit të kredisë për personat jofinanciar.**

**Në vitin 2023, bilanci i sistemit bankar u rrit me 62.485 milionë denarë, ose për 9,1%, që është përshejtim i rritjes krahasuar me një vit më parë (7,1%).** Bartës i rritjes vjetore janë depozitat më të larta nga subjektet jofinanciare, kapitali dhe rezervat (për shkak të mbajtjes së fitimeve nga viti 2022 dhe emetimeve të reja të aksioneve të zbatuara) dhe fitimet e realizuara në vitin 2023. Për sa i përket mjeteve, bankat kanë rritur ndjeshëm mjetet e tyre likuide (kryesisht, depozitat e disponueshme në Bankën Popullore, vendosjet në letrat me vlerë të qeverisë vendase dhe të huaja dhe fondet në llogarinë e pagesave në valutë në Bankën Popullore), si dhe vendosjet në kredi për subjektet jofinanciare, por me ritme më të ngadalta krahasuar me një vit më parë.

Grafiku nr. 71 A  
në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Me rritjen e përsheptuar të aktiveve të bankave, treguesit e ndërmjetësimit financiar shënuan rritje në vitin 2023.** Analiza krahasuese me vendet e tjera nga Europa Qendrore dhe Juglindore tregon për përmirësim të nivelit të ndërmjetësimit financiar në vendin tonë, por ende relativisht modest.



Grafiku nr. 72 Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (majtas) dhe sipas vendeve individuale (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka Popullore dhe EShS-ja, bazuar në të dhënat e ofruara nga bankat, FMN-ja dhe faqet e internetit të bankave qendrore individuale.

### 1.1. Kreditë e subjekteve jofinanciare<sup>77</sup>

**Kreditimi për sektorin jofinanciar nga bankat vijon të rritet gjatë vitit 2023, por me ritme më të ngadalta krahasuar me një vit më parë.** Në vitin 2023, totali i kredive të sektorit jofinanciar u rrit për 18.037 milionë denarë, ose për 4,3%. Njëkohësisht, rreth 80% e rritjes vjetore të aktivitetit kreditues është rezultat i rritjes së kreditimit për amvisëritë, ku ngadalësimi i rritjes ka qenë më i dobët se kreditimi për biznese. Ngadalësimi i rritjes së kredisë ndodh në kushtet e rritjes së normave të interesit dhe shtrëngimit të përgjithshëm neto të kushteve të kredisë dhe në të njëjtën kohë një kërkesë neto të reduktuar për kredi.<sup>78</sup> Analiza e bankave të veçanta tregon se shtatë nga gjithsej dymbëdhjetë banka kanë shënuar rritje të kreditimit<sup>79</sup>, dhe nxitësi kryesor i rritjes është rritja e kreditimit nga bankat e mëdha.

<sup>77</sup> Kreditë e subjekteve jofinanciare përfshijnë kreditë e personave jofinanciar - rezidentë dhe jorezidentë, përkatësisht kreditë e shoqërive private dhe publike jofinanciare, pushtetit qendror, vetëqeverisjes vendore, institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve (kredi për klientët e tjerë), operatorët e pavarur të biznesit dhe personat fizikë (kredi shtëpiake).


<sup>78</sup> Në pajtueshmëri me të katër anketat e aktivitetit kreditor të publikuar në vitin 2023, vërehet shtrëngim neto në kushtet e kreditimit si për bizneset ashtu edhe për amvisëritë, ndërkohë që kërkesa për kredi në të dy sektorët ka shënuar rënie neto (i vetmi përjashtim është rritja e vogël neto e kërkesës për kredi të korporatave në Anketën e Aktivitetit të Kredisë për tremujorin e dytë të 2023). Norma bazë e interesit e Bankës Popullore u rrit nga 4,75% në fund të vitit 2022 në 6,30% në fund të vitit 2023.

<sup>79</sup> Nuk merret parasysh BZHMV-ja ShA Shkup.



Grafiku nr. 73

Shuma dhe norma vjetore e ndryshimit të kredive për subjektet jofinanciare (majtas) dhe kredive të miratuara rishtazi sipas sektorëve individualë (djathtas) në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Vëllimi i kredive të reja të sektorit jofinanciar<sup>80</sup> në vitin 2023 shënuan rënie prej 1,7% pas rritjes së lartë dyshifrore të një viti më parë.** Rënia vjen si pasojë e zvogëlimit të kredive të reja të miratuara për ndërmarrjet (me 5,4%), ndërsa kreditë e reja të miratuara për ekonomitë e amvisërive shënuan rritje (me 3,8%). Më pak kredi e re për ndërmarrjet në vitin 2023 mund të lidhet me rritjen e nevojave të likuiditetit të vitit të kaluar të sektorit të korporatave për shkak të çmimeve gjithnjë e më të larta të karburanteve në vitin 2022.

Grafiku nr. 74

Rritja vjetore e totalit të kredive për subjektet jofinanciare (majtas) dhe e kredive për shoqëritë jofinanciare dhe amvisëritë (djathtas), sipas bankave individuale në milionë denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: BZHRMV-ja nuk është përfshirë nga analizat.

**Kreditë e ndërmarrjeve shënuan ngadalësim të ndjeshëm të rritjes në vitin 2023 pas rritjes së dukshme në dy vitet e mëparshme.** Më 31.12.2023, totali i kredive të

<sup>80</sup> Për analizën e kredive të reja të miratuara, sektori jofinanciar përfshin vetëm personat juridikë dhe amvisëritë, ndërsa klientët e tjerë janë të përjashtuar për shkak të luhatjeve të mëdha në shumat e kredive të reja të miratuara.




ndërmarrjeve u rrit me 6.574 milionë denarë, ose për 3,2%<sup>81</sup> krahasuar me fundin e një viti më parë (ritje për 21.595 milionë denarë, ose për 11,8% në vitin 2022). Rritja e kredisë është ndikuar nga rritja e lartë e kreditimit për sektorin e energjentëve (për 44,8%)<sup>82</sup> dhe për sektorin e ndërtimit (deri në 7,5%), por nga ana tjetër kufizohet nga rënia e kredisë për prodhimin e metaleve, makinerive, veglave dhe pajisjeve (për 9,3%), në industrinë ushqimore (për 2,4%) dhe në tregtinë me shumicë dhe pakicë (për 1,5%). Rritja e ngadaltë e kredisë për ndërmarrjet ndodh në kushtet e një shtrëngimi neto të kushteve të kredisë gjatë gjithë vitit, dhe kjo shprehet veçanërisht në termat e normave të interesit, të ardhurave pa interes dhe kërkesave për kolateral, si dhe ulje të ndjeshme neto të kërkesës për kredite krahasuar me vitin 2022. Megjithatë, pritjet për tremujorin e parë të vitit 2024 tregojnë për lehtësim neto të kushteve të kreditimit për ndërmarrjet me rritje neto më të fortë të kërkesës për kredi.<sup>83</sup>

Analizuar sipas madhësisë së kompanive jofinanciare<sup>84</sup>, kreditë për ndërmarrjet e mëdha kanë pjesëmarrjen më të madhe (36.0%), e cila është rritur në krahasim me fundin e vitit paraprak, dhe pjesëmarrja e kredisë për ndërmarrjet mikro (7,6%) është më e ulët dhe paraqet rënie, e cila është pjesërisht rezultat i shumave më të larta të kredive për ndërmarrjet më të mëdha. Për sa i përket aktivitetit të klientëve, pjesëmarrjen më të madhe kanë kreditë e ndërmarrjeve që merren me industri (32,4%), tregtisë me shumicë dhe pakicë (27,7%) dhe ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimit (19,9%)<sup>85</sup>.

Grafiku nr. 75

Struktura e kredive për shoqëritë jofinanciare, sipas aktiviteteve individuale dhe sipas madhësisë së shoqërisë në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* Vërejtje: Përfshihet efekti i të gjitha fshirjeve të detyrueshme të kryera në periudhën 1.1.2016 – 31.12.2023. Duke filluar nga dhjetori 2019, të dhënat përfshijnë edhe kreditë e grumbulluara të fshira të detyrueshme

<sup>81</sup> Nëse përfshihet efekti i fshirjeve të detyrueshme neto, rritja vjetore e kredive për shoqëritë jofinanciare arrin në 3,0% (10,7% në 31.12.2022).

<sup>82</sup> Kontribut të caktuar në këtë rritje ka edhe masa e Bankës Popullore për lirim nga rezerva e detyrueshme e kredive për ndërtimin e objekteve të reja ose për rritjen e fuqisë së instaluar të objekteve ekzistuese për prodhimin vendor të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

<sup>83</sup> Burimi: Anketa për aktivitetin kreditor në tremujorin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të vitit 2023.


<sup>84</sup> Kriteret për klasifikimin e subjekteve sipas madhësisë (të mëdha, të mesme, të vogla dhe mikro) jepen në nenin 470 të Ligjit të Shoqërive Tregtare. Të dhënat për strukturën e kredive të korporatave sipas madhësisë (dhe të kryqëzuara, sipas madhësisë dhe aktivitetit të klientëve) janë marrë nga bankat bazuar në një kërkesë të veçantë për të dhëna.

<sup>85</sup> Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore bazuar në të dhënat e ofruara nga bankat.



Grafiku nr. 76

Struktura e kredive për shoqëritë jofinanciare, sipas aktiviteteve individuale dhe sipas madhësisë së shoqërisë në përqindje




Burimi: Të dhëna të siguruar nga bankat në bazë të një kërkesë për të dhëna.

**Në vitin 2023 mundësohet edhe mbështetje kreditore për amvisëritë, por më ngadalë, megjithëse ngadalësimi është dukshëm më i moderuar në krahasim me kreditimin e ndërmarrjeve.** Kredia totale e amvisërive në vitin 2023 është rritur me 14.649 milionë denarë, ose për 6,9%<sup>86</sup> (rritje prej 15.167 milionë denarë, ose për 7,7% më 31.12.2022). Kjo normë rritjeje është nën mesataren dhe është në nivelin e normës minimale të rritjes në dhjetëvjeçarin e fundit. Ngjashëm me kreditimin për ndërmarrjet, gjatë vitit 2023 vërehet shtrëngim neto i kushteve të kredisë dhe rënie neto e kërkesës për kredi. Pritjet për zhvillimet në tremujorin e parë të vitit 2024 kontribuojnë në lehtësim të moderuar neto të kushteve të kredisë dhe rritje neto të kërkesës për kredi.<sup>87</sup>

Grafiku nr. 77

Normat vjetore të ndryshimit të kredive për ndërmarrjet (majtas) dhe amvisëritë (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka Popullore dhe Regjistri i Kredive të Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

<sup>86</sup> Nëse zbritet efekti i fshirjeve neto, norma e rritjes vjetore është më e lartë dhe arrin në 7,1% (7,9% më 31.12.2022).


<sup>87</sup> Burimi: anketa të aktivitetit kreditor në tremujorin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të vitit 2023.




Grafiku nr. 78

Struktura sektoriale e kredisë për subjektet jofinanciare, sipas bankës individuale (majtas) dhe struktura e kredisë për personat fizikë, sipas produkteve (djathtas)

në përqindje



në milionë denarë dhe në përqindje në shenja



Burimi: Regjistri i Kredive i Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat..


Për shkak të lëvizjeve të tilla, pjesëmarrja e kredisë për amvisëritë është 51,3% në strukturën e kredisë për sektorin jofinanciar, që është rritje prej 1,3 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e vitit 2022, ndërsa pjesëmarrja e kredisë së ndërmarrjeve është 48,1%, që paraqet rënie prej 05 pikë përqindjeje.<sup>88</sup> Sipas llojit të produkteve të kredisë, kreditë për personat fizikë për financimin e konsumit zënë 62,8%, ku përfshihet edhe pjesëmarrja prej 54,2% e kredive konsumatore, ndërsa kredia për objekte banimi dhe biznesi marrin pjesë me 37,2% në strukturën totale të kredisë për persona fizikë. Raporti i pjesëmarrjeve ndërmjet kredisë konsumatore dhe kredisë për banesa vijon të ngushtohet për shkak të rritjes më të shpejtë të kredisë për banesa (rritje vjetore prej 10,0% e kredisë për banesa krahasuar me rritjen prej 6,6% të kredisë konsumatore më 31.12.2023).

<sup>88</sup> Pjesëmarrja e kredive të amvisërive në numrin e përgjithshëm të kredive në fund të vitit 2023 është 0,6% dhe është dukshëm më e ulët se në fund të vitit 2022 kur ishte 1,4%.



Grafiku nr. 79

Pjesëmarrja e kredive të "gjelbra" në numrin e përgjithshëm të kredive të subjekteve jofinanciare dhe sipas sektorëve individualë, e sipas bankave individuale në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Kreditë e gjelbra<sup>89</sup> vazhdojnë të rriten me shpejtësi gjatë vitit 2023, gjë që ka kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në portofolet e kredisë së bankave, por ajo është ende e ulët në lartësinë e 4,5%<sup>90</sup>.** Gjatë vitit 2023, gjithsej kreditë e gjelbra u rritën me 4.474 milionë denarë, ose 29,1%, që i detyrohet vetëm rritjes së lartë të kreditimit të gjelbër për ndërmarrjet me 32,4%, ndërsa kreditë e gjelbra të amvisërive u ulën me 6,4%.

Grafiku nr. 80

Struktura e totalit të kredive, sipas sektorëve (majtas) dhe valutës (në mes) dhe struktura e kredive të rregullta sipas maturitetit (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Vërejtje: Kreditë me probleme nuk përfshihen në grafikun në të djathtë

<sup>89</sup> Për qëllimet e këtij raporti, kreditë e gjelbra konsiderohen kredi që synojnë të përmirësojnë efikasitetin energjetic të amvisërive dhe sektorit të korporatave; kredi për të mbështetur investimet në teknologjitë, materialet dhe zgjidhjet e gjelbra; kredi për të mbështetur investimet në burimet e rinovueshme të energjisë, kontrollin dhe parandalimin e ndotjes, mbrojtjen e mjedisit, reduktimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike, etj.

<sup>90</sup> Nga dymbëdhjetë bankat e analizuar, vetëm një bankë nga grupi i bankave të vogla nuk ka aprovuar kredinë e gjelbër më 31.12.2023. Në bankat që kanë miratuar kredi të tilla, pjesëmarrja e kredisë së gjelbër në totalin e kredive varion nga 0,1% në 20,5%. Nga pikëpamja sektoriale, përfaqësimi i kredisë së gjelbër në totalin e kredisë nga bankat individuale është ndërmjet 0,001% dhe 21,9% për ndërmarrjet, pra midis 0,0% dhe 13,8% për amvisëritë.




**Analiza e kredive sipas valutës tregon për rritje të ngadaltë të kredive në denarë dhe kredive me komponentë valutore, ndërsa pak mbi 80% e rritjes së gjithsej kredive për subjektet jofinanciare është rezultat i rritjes së kredive në denarë.** Krahësuar me fundin e vitit 2022, kreditë në denarë janë rritur për 14.714 milionë denarë, ose për 6,1%<sup>91</sup>, ndërsa kreditë me komponentë valutore janë rritur për 3.324 milionë denarë, ose për 1,8%<sup>92</sup>. Në strukturën valutore, kreditë në denarë kanë pjesëmarrje më të lartë prej 57,8%, e cila është rritur për 1,0 pikë përqindjeje në bazë vjetore. Tek kreditë me komponentë valutore, kreditë në denarë me klauzolë valutore (25,1%) kanë pjesëmarrje më të lartë në krahasim me kreditë në valutë (17,1%).

**Sipas afatit të maturimit të kredive<sup>93</sup>, rritja e kredisë vjen kryesisht nga rritja e kredisë afatgjatë, ndërsa kredia afatshkurtër shënon rënie.** Më 31.12.2023, kreditë afatgjata janë rritur për 24.186 milionë denarë, ose 7,2% (ritje për 27.151 milionë denarë, ose për 8,8% më 31.12.2022), dhe kreditë afatshkurtra janë ulur me 6.469 milionë denarë, ose 9,0% (ritje me 12.174 milionë denarë, ose 20,3% më 31.12.2022). Në strukturën afatgjatë të kredisë, pjesëmarrja e kredisë afatgjatë u rrit në 84,3% në barrë të uljes së pjesëmarrjes së kredisë afatshkurtër në 15,3%. Rritje kanë pësuar edhe kreditë e maturuara, por lëvizjet e tyre janë mjaft të ndryshueshme për shkak të shumës së parëndësishme të tyre<sup>94</sup>.

Grafiku nr. 81

Rritja vjetore e kredive, sipas sektorit (majtas), valutës (në mes) dhe maturitetit (djathtas) në milionë dhe në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

<sup>91</sup> Rritja e kredive në denarë për sektorin jofinanciar në bazë vjetore vjen si pasojë e rritjes së kredive të ndërmarrjeve për 8.579 milionë denarë, ose për 7,0% dhe për amvisëritë për 6.210 milionë denarë, ose për 5,3%, ndërsa rënie ndodh në kreditë e klientëve të tjerë për 75 milionë denarë, ose për 5,4%.

<sup>92</sup> Rritja e kredive me komponentë valutore për sektorin jofinanciar në baza vjetore është rezultat i rritjes së kredive në denarë me klauzolë devizore për 2.788 milionë denarë, ose për 2,6%, si dhe kreditë më të larta në valutë për 535 milionë denarë, ose për 0,7%. Rritja e kredive në denarë me klauzolë devizore është në tërësi për shkak të rritjes së kredive për ekonomitë e amvisërive (për 6.204 milionë denarë, ose për 7,7%), ndërsa kreditë e ndërmarrjeve shënuan rënie (për 3.262 milionë denarë, ose për 12,5%) dhe kreditë e klientëve të tjerë (për 154 milionë denarë, ose për 17,7%). Rritja e kredisë në valutë është rezultat i rritjes së kredisë për amvisëritë (për 2.235 milionë denarë, ose për 15,9%) dhe e ndërmarrjeve (për 1.257 milionë denarë, ose për 2,2%), në rast të rënies së madhe të kredisë në valutë të klientëve të tjerë (për 2.957 milionë denarë, ose për 79,6%).

<sup>93</sup> Analiza e strukturës së maturitetit përjashton kreditë me probleme.

<sup>94</sup> Kreditë e maturuara përbëjnë minimum prej 0,4% të totalit të kredive të rregullta.




## 1.2. Depozitat e subjekteve jofinanciare

**Në vitin 2023, depozitat nga subjektet jofinanciare shënuan rritje të përsheptuar nga 45.648 milionë denarë, ose për 9,2% (në vitin 2022 janë rritur për 25.111 milionë denarë, ose për 5,4%).**

**Nga pikëpamja sektoriale, rritja vjetore e depozitave kushtëzohet më së shumti nga sektori "amvisëri", e cila në bazë vjetore është rritur për 25.730 milionë denarë, ose për 7,8%, që paraqet rritje të përsheptuar krahasuar me një vit më parë kur shënuan rritje prej 19.385 milionë denarë, ose për 6,3%. Në të njëjtën kohë, depozitat nga ky sektor kanë pjesëmarrjen më të lartë në bazën e depozitave të bankave (65,6%). Përsheptim të dukshëm të rritjes vjetore shënuan edhe depozitat nga shoqëritë jofinanciare, të cilat arritën në 19.553 milionë denarë, ose 13,2% (rritja në vitin 2022 ishte 5.354 milionë denarë, ose 3,8%).**

Grafiku nr. 82 Gjendja (majtas) dhe ndryshimi (djathtas) në depozitat e subjekteve jofinanciare në milionë denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.


**Denarizimi i bazës së depozitave është shënuar edhe gjatë vitit 2023.** Kështu, nga aspekti valutor, kontributin më të madh në rritjen vjetore të gjithsej depozitave nga subjektet jofinanciare e ka pasur rritja e depozitave në denarë. Rritja vjetore e këtyre depozitave arrin në 34.551 milionë denarë ose për 13% (6.888 milionë denarë, ose 2,7% në vitin 2022), i cili kontribuoi me 75,7% në rritjen vjetore të totalit të depozitave nga subjektet jofinanciare. Depozitat në denarë nga sektori i ekonomive të amvisërive shënuan rritje vjetore prej 18.648 milionë denarë, ose për 11,9% dhe kanë kontributin më të madh në rritjen e depozitave në denarë (54,0%). Rritje të theksuar të depozitave në denarë kanë shënuar edhe ndërmarrjet, dhe atë për 15.666 milionë denarë, ose për 15,8% dhe kontribuoi me 45,3% në rritjen e depozitave në denarë. Ndryshimet e tilla në prirjet valutore të depozituesve për t'i mbajtur mjetet e tyre në denarë, përveç rendimenteve më të larta dhe pritjeve të qëndrueshme, u inkurajuan edhe nga masat e marra nga Banka Popullore, kryesisht nëpërmjet instrumentit të rezervës së detyrueshme, i cili nxit kursimin në valutën vendase.

Për dallim nga rritja e përsheptuar e depozitave në denarë, depozitat në valutë shënuan rritje më të ngadaltë (Rritja e tyre vjetore është ngadalësuar nga 8,7% ose 18.382 milionë denarë në vitin 2022, në nivelin prej 4,8% ose 11.064 milionë denarë në vitin 2023). Kështu,




pjesëmarrja e tyre në strukturën e gjithsej depozitave u zvogëlua nga 46,3% në vitin 2022 në 44,4% në vitin 2023, kundrejt rritjes së pjesëmarrjes së depozitave në denarë (nga 53,6% më 31.12.2022 në 55,5% më 31.12.2023).

Grafiku nr. 83 Pjesa e totalit të depozitave në valutë në totalin e depozitave të sistemit bankar (majtas) dhe e depozitave në valutë të amvisërive në totalin e depozitave të amvisërive (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 84 Struktura e maturimit të depozitave të amvisërive në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Dhe në vitin 2023 ka pasur ndryshime të favorshme për sa i përket maturitetit të depozitave.** Kështu, depozitat afatgjata shënuan normën më të lartë të rritjes vjetore në dhjetë vitet e fundit (25,7% ose 24.816 milionë denarë)<sup>95</sup>, e cila e ka tejkaluar rritjen e


<sup>95</sup> Rritja vjetore e depozitave afatgjata vjen si nga rritja e depozitave në denarë (për 13.394 milionë denarë ose për 28,2%), ashtu edhe nga rritja e depozitave në valutë (për 11.365 milionë denarë ose për 23,1%).



## Raport i rreziqeve në sistemin bankar për vitin 2023

depozitave pa afat (7,0% ose 23.001 milionë denarë), me rënie të mëtejshme të depozitave afatshkurtra (në vitin 2023 janë ulur për 3,1% ose 2.169 milionë denarë).

Grafiku nr. 85 Struktura e totalit të depozitave sipas sektorit (majtas), valutës (në mes) dhe maturimit (djathtas) në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Rritja e lartë vjetore e depozitave afatgjata, në kushte ku ende ka norma kthimi më të larta dhe pritshmëri të qëndrueshme, shkaktoi rritje më të ndjeshme (prej 2,9 pikë përqindje) mbi pjesëmarrjen strukturore të depozitave afatgjata në totalin e depozitave (deri në nivelin 22.5%), në barrë të uljes së pjesëmarrjes së depozitave pa afat dhe atyre afatshkurtra. Megjithatë, depozitat pa afat kanë pjesëmarrje më të lartë strukturore prej 65,1% (66,4% më 31.12.2022).

Analizuar nga këndvështrimi sektorial, pjesëmarrje më të madhe (85,6%) në rritjen vjetore të depozitave afatgjata e kanë depozitat afatgjata të ekonomive të amvisërive (si në valutë të huaj ashtu edhe në denarë), të cilat u rritën për 21.240 milionë denarë (ose me 25,7%). Kështu, depozitat afatgjata rritën pjesëmarrjen strukturore në totalin e depozitave të amvisërive, me 4,2 pikë përqindje, në nivelin 29,3%. Megjithatë, edhe tek amvisëritë, depozitat pa afat kanë pjesëmarrje më të lartë strukturore në totalin e depozitave (54,7% më 31.12.2023, kundrejt 56,7% më 31.12.2022).

Grafiku nr. 86 Ndryshimi vjetor i depozitave, sipas sektorit (majtas), valutës (në mes) dhe maturimit (djathtas) në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.



### 1.3. Aktivitetet e tjera

**Pas rënies së vitit të kaluar, plasmanet e bankave në letra me vlerë, filiale dhe shoqëri të lidhura<sup>96</sup> në vitin 2023 shënuan rritje,** për 11,983 milionë denarë (ose për 13,8%), duke e rritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej asetet e bankave në nivelin prej 13,3% (12,7% në fund të vitit paraprak). Normën më të lartë të rritjes vjetore e kanë shënuar pjesa tjetër e investimeve të bankave në letra me vlerë me rritje prej 4,073 milionë denarë, ose afër 66%, e cila vjen si pasojë e vendosjeve të dy bankave të mëdha në bono dhe obligacione të emetuara nga qeveritë qendrore të huaja. Rritje të lartë prej rreth 23% (3,751 milionë denarë) kanë pasur edhe investimet në bono të thesarit vendor. Norma më të ulëta të rritjes vjetore shënuan investimet në obligacione shtetërore prej 3,677 milionë denarë ose 6,7%, ndërsa investimet e bankave në bono thesari shënuan rritje modeste prej 482 milionë denarë, ose 5,1%<sup>97</sup>. Kështu, struktura e investimeve në letra me vlerë është pothuajse e pandryshuar, me rënie, por pjesëmarrje më të madhe të plasmaneve në obligacionet e qeverisë vendase dhe eurobonot nga 59,3% (63,2% më 31.12.2022), dhe në të njëjtën kohë, investimet e tjera në letra me vlerë shënuan rritje të pjesëmarrjes, duke arritur 10,4% (7,1% më 31.12.2022).

Grafiku nr. 87 Struktura (majtas) dhe ndryshimi tremujor (djathtas) i investimeve në letrat me vlerë, filialet dhe shoqëritë të lidhura në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Nga ana e aktiveve, vendosjet me banka dhe institucione të tjera financiare (zënë 7,3% nga gjithsej asetet e sistemit bankar) në vitin 2023 shënuan rritje prej 1.971 milionë denarë, ose për 3,7%.** Kjo rritje, në pjesën më të madhe, ka ardhur nga rritja e kredisë për bankat vendase<sup>98</sup> për 2.298 milionë denarë, ose për 15,7%. Llogaritë dhe depozitat në bankat vendase në vlerë prej 130 milionë denarë (depozita të afatizuara në valutë nga tri banka të vogla) shënuan rritje vjetore më të ulët prej 7,4%. Llogaritë dhe depozitat në bankat e

<sup>96</sup>Analizat e këtyre investimeve janë bërë në pajtim me vlerën e tyre kontabël neto.

<sup>97</sup> Në ankandet e bonove të thesarit, të mbajtura në vitin 2023, shuma e ofruar e bonove të thesarit mbeti e njëjtë, gjegjësisht 10.000 milionë denarë, dhe kërkesa u rrit gjatë vitit dhe (duke filluar nga ankandi i shtatorit) arriti nivelin e shumës së ofruar. Gjatë vitit 2023, Banka Popullore vazhdoi me rritjen e normës së interesit, me ç'rast norma e interesit në bonot e thesarit u rrit me gjithsej 1,55 p.p. në nivelin e 6,30%.


<sup>98</sup> Rritja vjetore e kredive bankare vendore pothuajse në tërësi rezulton nga rritja e kredive afatgjata bankare në valutë me afat mbi dy vjet në "BZHRM" ShA Shkup.



## Raport i rreziqeve në sistemin bankar për vitin 2023

huaja kanë shënuar rënie më të madhe në vlerë absolute prej 1.120 milionë denarë, ose për 3,2%, para së gjithash si pasojë e zvogëlimit të shumave të mjeteve në llogaritë korrespondente në bankat e huaja. Me gjithë rënien, llogaritë dhe depozitat në bankat e huaja vazhdojnë të kenë pjesëmarrje më të lartë në totalin e plasmaneve në banka dhe institucione të tjera financiare.

Grafiku nr. 88 Ndryshimi vjetor i kërkesës ndaj institucioneve financiare (majtas), detyrimeve të bazuara në kredi (djathtas) dhe depozitave nga institucionet financiare (në mes) në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Nga ana e detyrimeve, totali i detyrimeve të bankave bazuar në kredi (të cilat zënë 5,9% nga totali i detyrimeve të sistemit bankar) në bazë vjetore është rritur për 4.634 milionë denarë, ose për 11,8%, që është pothuajse njëloj rezultat i rritjes së detyrimeve të bazuara në kredi për institucionet financiare rezidente dhe jorezidente<sup>99</sup>. Në strukturën e totalit**


<sup>99</sup> Bëhet fjalë për obligime të bazuara në kredi në valutë nga dy deri në pesë vjet dhe mbi pesë vjet nga "BZHRM" ShA Shkup ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare, të cilat më pas janë të plasuarua përmes bankave tjera komerciale në sistem dhe mbi këtë bazë bankat komerciale regjistrojnë detyrime ndaj "BZHRM" ShA Shkup.



të detyrimeve të bankave në bazë të kredisë, mbizotërojnë detyrimet e bazuara në kredi ndaj institucioneve financiare jorezidente. **Depozita nga bankat dhe institucionet e tjera financiare** shënoi rënie, duke përfaqësuar ende burim modest financimi për bankat, **me pjesëmarrje prej 5,1% në totalin e detyrimeve të sistemit bankar**. Rënia vjetore e depozitave nga bankat dhe institucionet tjera financiare prej 3.031 milionë denarë (për 7,3%), Më së shumti rezulton nga rënia e depozitave të institucioneve financiare rezidente (për 2.162 milionë denarë, ose për 10,4%), brenda të cilit rënien më të madhe e kanë depozitat e fondeve pensionale (2.992 milionë denarë). Depozitat nga institucionet financiare jorezidente, të cilat në fund të vitit 2023 përbëjnë 51,5% të gjithsej depozitave nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, shënuan rënie vjetore shumë më të vogël, nga 869 milionë denarë, ose 4,2%.

**Shtrirja dhe shkalla e aktiviteteve të sistemit bankar me jorezidentët është vazhdimisht shumë e kufizuar. Ashtu si vitin e kaluar, më 31.12.2023, bankat në nivel sistemi kanë më shumë borxhe<sup>100</sup> se sa pretendojnë nga jorezidentët, me rritje minimale të detyrimeve dhe ulje të dëmeve.** Konkretisht, detyrimet e bankave vendase ndaj jorezidentëve shënuan rritje të lehtë vjetore (nga 678 milionë denarë, ose për 1,1%), të cilat uli pjesëmarrjen e tyre në totalin e detyrimeve të sistemit bankar, në nivelin e 8,1%<sup>101</sup> në fund të vitit 2023. Rritja vjetore rezulton pothuajse tërësisht nga rritja e detyrimeve të bazuara në kreditë afatgjata në valutë për institucionet financiare jorezidente. Në pretendimet e bankave nga jorezidentët, u shënuar një rënie vjetore prej 1.094 milionë denarë, ose 2,9%, në masë të madhe si pasojë e zvogëlimit të tepricave të llogarive korrespondente

Grafiku nr. 89 Detyrime (majtas) dhe kërkesat (djathtas) ndaj/nga jorezidentët në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* Pa pjesëmarrjen e "BZhMV-së" ShA Shkup.


<sup>100</sup> Më 31.12.2023, shtatë nga gjithsej trembëdhjetë banka kanë më shumë borxh sesa pretendojnë ndaj jorezidentëve.

<sup>101</sup> Nëse nga analiza përjashtohet "BZhRM" ShA Shkup, pjesëmarrja e detyrimeve ndaj jorezidentëve në gjithsej detyrimet është 6.3%.



**Detyrimet ndaj subjekteve amë të bankave shënuan rënie dhe ende nuk përfaqësojnë një burim të rëndësishëm financimi të veprimtarisë së bankave vendase.** Në vitin 2023, detyrimet e bankave ndaj subjekteve amë janë zvogëluar për 1.023 milionë denarë (ose për 4%), që është kryesisht rezultat i uljes së detyrimeve të bazuara në instrumente të varur ndaj subjekteve amë (dhe personave të lidhur me to). Për rrjedhojë, pjesa e detyrimeve të bankave ndaj subjekteve amë (përfshirë detyrimet e varura dhe instrumentet hibride të kapitalit) në totalin e detyrimeve të sistemit bankar vendas dhe në detyrimet ndaj jorezidentëve janë ulur në 3,9% dhe 40,5%<sup>102</sup>. Kërkesat nga personat e regjistruar shënuan rënie minimale vjetore prej 232 milionë denarë, ose për 7,2%, duke e ulur kështu pjesëmarrjen edhe ashtu të ulët në gjithsej mjete në nivelin prej 0,4% (0,5% më 31.12.2022) dhe në kërkesat nga jorezidentët në nivel të 7,9% (8,7% më 31.12.2022).

Grafiku nr. 90 Detyrimet (lartë) dhe kërkesat (poshtë) tek/nga shoqëritë amë të bankave në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

## 2. Profitabiliteti

**Në vitin 2023, sistemi bankar vendas e rriti fitimin në mënyrë më të ndjeshme krahasuar me një vit më parë. Në kushte të së normave të interesit dhe aktiveve me**

<sup>102</sup> Më 31.12.2022, këto pjesëmarrje shënonin 4,3% dhe 42,7%.




interes, rezultati më i lartë financiar është kushtëzuar nga rritja e të ardhurave neto nga interesi, rritja e të cilave është kontribuar nga të ardhurat nga interesi pothuajse nga të gjithë sektorët. Kontribut të vogël në rritjen e fitimit kanë pasur të ardhurat neto më të larta nga komisionet. Shpenzimet në të gjitha bazat shënuan rritje. Rritja e përshpejtuar e fitimit ndikoi pozitivisht në treguesit bazë të profitabilitetit dhe efikasitetit operacional të sistemit bankar. Normat e interesit si për kreditë ashtu edhe për depozitat do të rriten në vitin 2023, por rritja e diferencës mes tyre është e vogël dhe arrin në 0,1 p.p.

## 2.1. Treguesit e profitabilitetit dhe të efikasitetit të sistemit bankar

**Sistemi bankar në vitin 2023 ka realizuar fitim prej 14.296 milionë denarë, që në krahasim me vitin paraprak është më i madh për 4.621 milionë denarë, ose për 47,8%.** Kontribut më të madh në rritjen e profitit kanë të hyrat neto më të larta nga interesi (rritje prej 7,493 milionë denarë, ose për 47,8%), dhe kontributi pozitiv, por shumë më i vogël i të hyrave neto nga komisionet dhe tarifat (rritja e të cilave është 319 milionë denarë) denarë, ose për 5,1%).<sup>103</sup> Zërat kryesorë të shpenzimeve të bankave shënuan rritje në vitin 2023, më së shumti në shpenzimet operative (rritje prej 1.962 milionë denarë, ose për 14,6%), rritja e të cilave pothuajse është dyfishuar në krahasim me vitin 2022 (rritje prej 976 milionë denarë, ose për 7,8%). Me rritjen e fitimit u rrit edhe tatimi në fitim (për 664 milionë denarë), ndërsa rritje të moderuar prej 137 milionë denarë (ose për 3,2%) shënoi edhe kostoja e korrigjimit të vlerës. E analizuar sipas bankave individuale, të gjitha bankat, me përjashtim të një banke të vogël, kanë arritur një rezultat financiar pozitiv nga veprimtaria e tyre.

Grafiku nr. 91 Lëvizja e fitimit total të bankave (majtas) dhe ndryshimi vjetor i tij (djathtas) në milionë denarë




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

<sup>103</sup> Komisionet dhe tarifat për shërbimet e pagesave, huadhënien dhe operacionet e thesarit të bankave përbëjnë pjesën më të madhe (68,1%) të totalit të të ardhurave neto nga komisionet dhe tarifat në vitin 2023 (60,4% në 2022). Nga ana tjetër, kontributin më të madh në rritjen vjetore të të ardhurave neto nga komisionet dhe tarifat e kanë komisionet e mbledhura në lidhje me transaksionin e pagesave jashtë vendit, rritja e të cilave tejkalon rritjen e totalit të të ardhurave neto nga komisionet, ndërsa në të njëjtën kohë të ardhurat neto nga komisionet në lidhje me operacionet me kartela të bankave.




Grafiku nr. 92 Kontribut në formimin e fitimit (majtas) dhe kontribut në rritjen e fitimit (djathtas) të bankave në milionë denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 93 Norma vjetore e ndryshimit të zërave kryesorë të të ardhurave (majtas) dhe shpenzimeve (djathtas) të bankave në përqindje




Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Të hyrat neto më të larta nga interesi i bankave bazohen në rritjen më të madhe të të hyrave nga interesi (për 9.711 milionë denarë, ose për 47,0%), krahasuar me rritjen e shpenzimeve nga interesi (për 2.219 milionë denarë, ose për 73,9%).** Në të njëjtën kohë, të ardhurat neto nga interesi pothuajse nga të gjithë sektorët shënuan rritje, me rritje më të lartë të të ardhurave nga interesi krahasuar me rritjen e shpenzimeve për interesa. Ndërmjetësimi financiar me amvisëritë ka kontribut më të madh në formimin e të ardhurave neto nga interesi (44,4%), ndërsa kontribut më të madh në rritjen e të ardhurave neto nga interesi e kanë pasur të ardhurat neto nga interesat nga shoqëritë jofinanciare (39,5%). Të ardhurat neto nga interesi nga shoqëritë jofinanciare dhe nga ekonomitë e amvisërisë janë rritur në bazë vjetore për 2.958 milionë denarë, përkatësisht për 45,3% dhe 1.214 milionë denarë, përkatësisht për 12,2%. Rritje relativisht e lartë e të ardhurave neto nga interesi vërehet edhe nga aktivitetet e bankave me institucionet financiare dhe shtetin.



Grafiku nr. 94


Të ardhurat neto nga interesi sipas sektorit, strukturës (majtas) dhe kontributit në rritje (djathtas) në milionë denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 95

Marzhi neto i interesit më 31.12.2023, sipas bankës individuale (majtas)\* dhe në nivel të sistemit bankar (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* Treguesit e nivelit të sistemit bankar paraqiten me vija.


**Pas disa vitesh ulje të njëpasnjëshme, marzhi neto i interesit shënoi rritje (me 1 pikë përqindje) në vitin 2023 dhe arriti nivelin prej 4,1%.** Zgjerimi i marzhit neto të interesit është rezultat i rritjes shumë më të shpejtë të të ardhurave neto nga interesi (42,4%) krahasuar me rritjen e aktiveve mesatare me interes (8,8%).



**Rritja e përshpejtuar e fitimit në vitin 2023 ndikoi pozitivisht në treguesit bazë të profitabilitetit<sup>104</sup> të sistemit bankar.** Krahasuar me fundin e vitit më parë, norma e kthimit të kapitalit dhe rezervave mesatare dhe treguesi i kthimit të aktiveve mesatare janë rritur përkatësisht me 3,9 dhe 0,5 pikë përqindje, ndërsa marzhi i fitimit ka shënuar rritje prej 5,9 pikë përqindjeje.

Grafiku nr. 96

Normat e kthimit mbi aktivet mesatare (ROAA) dhe kapitalin mesatar dhe rezervat (ROAE) dhe marzhin e fitimit në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

**Treguesit e efikasitetit operacional të sistemit bankar janë përmirësuar, me përjashtim të një treguesi që është përkeqësuar minimalisht.** Raporti ndërmjet shpenzimeve operative dhe të hyrave neto nga interesi, si dhe raporti ndërmjet shpenzimeve operative dhe totalit të të ardhurave të rregullta, shënuan përmirësim të ndjeshëm, dhe përkatësisht me 14,9 dhe 4,4 pikë përqindjeje, për shkak të rritjes më të shpejtë të të hyrave neto nga interesi (42,4%) dhe totalit të të hyrave të rregullta (26,2%)<sup>105</sup> në lidhje me rritjen e shpenzimeve operative (14,6%)<sup>106</sup>. Raporti ndërmjet shpenzimeve operative dhe aktiveve mesatare shënoi rritje të vogël prej 0,12 pikë përqindjeje

<sup>104</sup> Treguesit për përfitimin dhe efikasitetin e sistemit bankar dhe grupeve individuale të bankave janë paraqitur në shtojcat e këtij raporti.


<sup>105</sup> Rritja e gjithsej të hyrave të rregullta përcaktohet nga rritja e të hyrave neto nga interesi (për 7,493 milionë denarë, ose për 42,4%) dhe të ardhurat neto nga komisionet dhe tarifat (për 319 milionë denarë, ose për 5,1%).

<sup>106</sup> Në vitin 2023, shpenzimet operative janë rritur për 1.962 milionë denarë (ose 14,6%), nga të cilat rritja më e madhe është te shpenzimet e punëtorëve (për 985 milionë denarë, ose për 17,2%) dhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (për 644 milionë denarë, ose 12,4%).



Grafiku nr. 97


Treguesit e efikasitetit operacional  
në përqindje



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

Grafiku nr. 98

Shpenzimet e zhvlerësimit të mjeteve financiare dhe jofinanciare, (majtas) dhe ndryshimi vjetor të tyre (djathtas)\*  
në milionë denarë



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

\* Shuma për rregullimin neto në vlerë të mjeteve jofinanciare është e vogël, kështu që çdo ndryshim në këto mjete shkakton zhvendosje të mëdha në shkallët e rritjes vjetore


**Në datën 31.12.2023, kostot për korigjimin e vlerës së aktiveve financiare (në bazë neto) janë rritur, për 323 milionë denarë, ose për 7,5%, ndërsa të njëjtat kosto të**



**aktiveve jofinanciare kanë trajtimin e një zëri të ardhurash<sup>107</sup>, e cila rritet për 185 milionë denarë.** Rritja e kostove për korrigjimin e vlerës së aktiveve financiare vjen më së shumti nga rritja më e lartë e kostove bruto për korrigjimin e vlerës së kredive dhe vendosjeve në baza individuale (për 2.037 milionë denarë, ose për 19,9%), krahasuar me rritjen e lëshimit të korrigjimit të vlerës së këtyre kredive dhe plasmaneve (1.679 milionë denarë ose për 26,7%). Zvogëlimi i korrigjimit neto të vlerës së mjeteve jofinanciare, nga njëra anë, vjen si pasojë e uljes së kostos bruto të këtyre mjeteve (për 90 milionë denarë) dhe nga ana tjetër, e lirimit më të madh të korrigjimit të vlera e mjeteve jofinanciare (për 96 milionë denarë).

Grafiku nr. 99

Treguesit e pjesëmarrjes së shpenzimeve neto të zhvlerësimit në fitim dhe në të hyrat neto nga interesi



Burimi: Banka Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat


## 2.2. Lëvizjet e normave të interesit dhe të dallimit të interesit

Në fund të vitit 2023, norma totale e interesit në kredi dhe norma totale e interesit të depozitave ishte 5,47% dhe 1,79%, që paraqet rritje prej 1,03 dhe 0,93 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e vitit 2022 (që korrespondon me përqindje rritje vjetore prej 23,2% për kreditë dhe mbi 90% për depozitat) kur ishin 4,44% dhe 0,86%. Diferenca e normës së interesit u zgjerua, për shkak të rritjes më të lartë të normave aktive të interesit, krahasuar me rritjen e normave pasive të interesit. Diferenca ndërmjet normës totale të interesit të kredive dhe normës totale të interesit të depozitave më 31.12.2023 është 3,68 pikë përqindje, krahasuar me 3,58 pikë përqindjeje në fund të vitit 2022.

<sup>107</sup> Në vitin 2023, bankat lëshuan më shumë shpenzime për korrigjimin e vlerës së aktiveve jofinanciare sesa bënë të reja dhe për rrjedhojë shpenzimet e aktiveve jofinanciare kanë trajtimin e një zëri të ardhurash në fund të vitit.




Grafiku nr. 100 Normat e interesit aktive (majtas) dhe pasive (djathtas) në përqindje



Burimi: Banka Popullore.

Grafiku nr. 101 Dallimi i interesit në pikë përqindjeje



Burimi: Banka Popullore.